







Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije Lokalne Samopravo
Ministry of Local Government Administration



EU MEMBER
 STATES
28



DEPARTAMENTI PËR INTEGRIM EVROPIAN DHE KOORDINIM TË POLITIKAVE

“Udhëzues për rolin e komunave
 NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN TË KOSOVËS”





DEPARTAMENTI PËR INTEGRIM EVROPIAN DHE KOORDINIM TË POLITIKAVE
DIVIZIONI PËR INTEGRIME EVROPIANE

Dokumenti u punua nga:

Yll Valla

Email: yll.valla@rks-gov.net

Rozafa Ukimeraj

Email: rozafa.ukimeraj@rks-gov.net

Dizajni dhe faqosja:

Diellor Gashi

Email: diellor.gashi@rks-gov.net
diellor.gashi@gmail.com



**“UDHËZUES
PËR ROLIN E KOMUNAVE
NË PROCESIN E
INTEGRIMIT EVROPIAN
TË KOSOVËS”**



Shkurtesat

AC	Acquis Communautaire
BE	Bashkimi Evropian
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore Kombëtare
GJDBE	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
GJA	Gjykata e Audituesve
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës
KBE	Këshilli i Bashkimit Evropian
KE	Komisioni Evropian
KE	Këshilli Evropian
KPA	Këshilli i Përkohshëm Administrativ
MPPSA	Mekanizmi Përcjellës i Procesit të Stabilizim Asociimit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
PE	Parlamenti Evropian
PVPE	Plani i Veprimit të Partneritetit Evropian
RP	Raporti i Progresit
SEBQ	Sistemi Evropian i Bankave Qendrore
TBE	Traktati i Bashkimit Evropian
TFBE	Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës

Përmbajtja

HYRJE	7
PJESA E PARË (koncepte të përgjithshme mbi BE-në)	
HISTORIK I SHKURTËR I BE-së	9
STRUKTURA INSTITUCIONALE E BASHKIMIT EVROPIAN DHE ROLI I TYRE	12
PARLAMENTI EVROPIAN	14
KËSHILLI EVROPIAN	16
KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN	18
KOMISIONI EVROPIAN	19
GJYKATA E DREJTËSISË E BASHKIMIT EVROPIAN	22
BANKA QENDRORE EVROPIANE	23
GJYKATA E AUDITUESVE	25
PROCEDURA LEGJISLATIVE NË BASHKIMIN EVROPIAN DHE ROLI I INSTITUCIONEVE TË BE-së NË PROCESIN E ZGJERIMIT	25
Procedura legjislative në Bashkimin Evropian	25
Roli i institucioneve të BE-së në procesin e zgjerimit	28
PROCESI I ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË BE	29
E ARDHMJA E EVROPËS	33
PJESA E DYTË	
Roli dhe përgjegjësitë e Komunave në procesin e integrimit Evropian të Kosovës	35
Obligimet e MAPL-së dhe komunave në procesin e ri-integrimit të personave të riatdhesuar	38
Obligimet e komunave dhe mapl-së për zbatimin e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave	40
ANEKS 1: DATA HISTORIKE TË KOSOVËS NË PROCESIN E INTEGRIMEVE EVROPIANE (HISTORIKU I MARRËDHËNIEVE KOSOVË – BE)	41
ANEKS 2: DATAT KYÇE NË HISTORINË E INTEGRIMIT EVROPIAN	52
ANEKS 3: HISTORIK I SHKURTËR MBI KRIJIMIN E PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT	55
LITERATURA:	57



“UDHËZUES PËR ROLIN E KOMUNAVE NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN TË KOSOVËS”





H Y R J E

Ideja e hartimit të Udhëzuesit ka ardhur si rezultat i nevojës prioritare lidhur me njohjen e procesit të integrimit evropian, me theks të veçantë në “Procesin e integrimit Evropian të Kosovës”. Udhëzuesi do të shërbejë si dritare orientuese për të kuptuar më drejtë dhe më qartë funksionimin e familjes së madhe evropiane. Së këndejmi, ky udhëzues ngërthen në vete një përmbajtje të shtjelluar mirë duke përfshirë fazat më të rëndësishme të këtij procesi. Hapi i parë drejtë njohjes së Evropës fillon pikërisht nga termi i emërimit të saj, më pas me hedhjen e ideve themelore të vëna nga kontribut dhënësit më të spikatur evropian si Zhan Mone dhe Robert Schuman, në trajtimin e çështjeve se si ka ardhur deri tek lindja e Bashkimit Evropian, cili është

kuptimi dhe shpjegimi i konceptit të integrimit evropian dhe mbi cilat shtylla ngrihet Bashkimi Evropian, traktatet e BE-së si baza të rëndësishme mbi të cilat ka funksionuar dhe vazhdon së funksionuari BE, si dhe një mori çështjesh të tjera.

Në këtë kontekst, këto janë disa nga elementet bazike të cilat do të ndikojnë dukshëm në hapjen e horizontit dhe përfitimit të dijes lidhur me organizatën e quajtur Bashkim Evropian, organizatë e cila promovon dhe mbështetet në vlerat e përbashkëta si në: shtetin e së drejtës, ekonominë e tregut, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, solidaritetin shoqëror dhe mori vlerash të tjera. Në këtë drejtim, rol të pa diskutueshëm luajnë edhe institucionet të cilat janë

përgjegjëse apo bartëse kryesore të funksionimit dhe menaxhimit të BE-së.

Struktura institucionale është mjaftë karakteristike dhe e përbërë nga 7 institucione si: Parlamenti, Këshilli Evropian, Këshilli i Bashkimit Evropian, Komisioni Evropian, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, Banka Qendrore Evropiane dhe Gjykata Evropiane e Auditorëve. Të gjitha institucionet e BE-së ushtrojnë funksione dhe përgjegjësi të cilat janë të ndërlidhura ndërmjet vete, si dhe të konfiguruar me një kompleksitet të veçantë konform traktateve të BE-së, veçanërisht Traktatit të Lisbonës (si një lloj kushtetute) mbi të cilën thirret BE apo referohet në pjesën më të konsiderueshme të veprimtarisë së saj. Fokus i theksuar në



trajtimin e udhëzuesit është paraparë të jetë pika në kontekstin e çështjes se si është e rregulluar procedura legjislativë në Bashkimin Evropian dhe çfarë roli kanë institucionet e BE-së në procesin e zgjerimit. Ndërkaq, pas përfitimit të njohurive mbi fushat e lartpërmendura, do të kemi mundësinë të njihemi më për së afërmi me pjesën më kryesore të udhëzuesit, atë të procesit të anëtarësimit të Kosovës në BE.

Përmes kësaj, lexuesit në mënyrë të qartë do t'i ofrohet një pasqyrë konkrete dhe të përmbledhur mirë lidhur me procesin, duke filluar nga faza e aplikimit për anëtarësim e gjerë në fazën përmbyllëse të anëtarësimit. Fare në fund, një këndvështrim i përgjithshëm analitik mbi të ardhmen e Evropës, në kontekstin se si dhe ku parashihet të jetë Evropa, aspekti i sigurisë,

procesin e mëtutjeshëm i zgjerimit, ndryshimet e mundshme në BE përmes reformave, si dhe orientimi strategjik i Evropës drejt tendencës së krijimit të federatës apo të ashtuquajturës Shtetet e Bashkuara të Evropës.

Gjithashtu, objekt trajtimi i këtij udhëzuesi janë edhe çështjet që ndërlidhen me rolin dhe përgjegjësitë e komunave të Republikës së Kosovës në procesin e përbushjes së agjendës evropiane për Kosovën.

Dokumenti në fjalë trajton obligimet e komunave sa i përket krijimit të strukturave institucionale [përgjegjëse për integrimin evropiane, procesin e komunikimit dhe koordinimit me MAPL-në dhe MIE-në, procesin e ri-integrimit dhe ri-atdhesimit si dhe procesin e liberalizimit të vizave.

Prandaj, pjesa e parë e dokumenti përmban çështje të përgjithshme sa i përket historikut dhe strukturës së institucioneve dhe çështje tjera që ndërlidhen me Bashkimin Evropian, ndërsa pjesa e dytë trajton çështjet që ndërlidhen me obligimet e komunave dhe rolin e tyre për të përmbushur detyrat nga procesi i negocimit të MSA-së, ri-integrimit dhe ri-atdhesimit si dhe procesit të liberalizimit të vizave.

Qëllimi i këtij dokumenti është që të japë informacionin e nevojshëm për çështjet që ndërlidhen me BE-në dhe procesin e integrimit Evropian të Kosovës dhe do të shërbejë si një doracak për zyrtarët e Ministrisë që në punën e tyre të përditshme merren me integrimet Evropiane si dyhe Zyrtarët komunal për integritime Evropiane.



Historiku i BE-së

Historia e kontinentit të Evropës daton që nga kohët e mëhershme, atëherë kur civilizimet përjetuan arritjet të mëdha të zbulimeve shkencore, formimit mitologjik dhe gjeografik të koncepteve mbi Evropën. Mbi bazën e kësaj, termi “Evropë” u përdor për herë të parë gjatë civilizimit grek, por në dy kontekste: mitologjik dhe gjeografik. Prej etimologjisë së këtij termi mund të ngrihen shumë hipoteza, por megjithatë fjala greke eurus do të thotë e gjerë, duke e lidhur në këtë mënyrë Evropën me hapësira të gjera territoriale¹.

Nga viti 1900 shtetet e Evropës por edhe të botës, filluan përgatitjet ushtarake dhe rriten buxhetet shtetërore me qëllim të blerjes së armatimit dhe konsolidimit të ushtrive, ku këtë fakt e dëshmoi më së miri fillimi i Luftës së Parë Botërore dhe Luftës së Dytë Botërore, luftëra të cilat filluan nga viti 1914 deri në vitin 1945. Në këtë kontekst, Evropa u fut në një vorbull të luftërave dhe dominimeve të shteteve, kështu duke krijuar ndarjen në mes shteteve dhe krijimin e blloqeve bazuar në programet dhe orientimet politike. Lufta e Parë Botërore shkaktoi humbjen më të madhe historisë së njerëzimit me gjithsejtë 20 milionë njerëz të humbur dhe njëkohësisht dëme të mëdha materiale.

Të gjitha kontinentet e botës u përfshin në këtë luftë madhore, mirëpo fokusi apo përqendrimi shkonte direkt tek dy vendet kryesore të Evropës, Gjermaninë dhe Francën. Po ashtu, Lufta e Dytë Botërore ishte edhe më e rëndë se Lufta e Parë Botërore, luftë e cila shkaktoi dëme të mëdha njerëzore dhe materiale. Qytetet më të bukura evropiane humbën arkitekturën dhe trashëgimin kulturore. Pas tërë kësaj katrahure,



Fig 1. Një nga hartat e periudhës antike të Evropës

Shtetet e Bashkuara të Amerikës duke e parë gjendjen e pafavorshme e cila ishte krijuar në Evropë dhe e cila rezultonte me një pasiguri të lartë, vunë në lëvizje idetë strategjike për ta mbrojtur Evropën Perëndimore nga Bashkimi Sovjetik.

Në këtë kontekst, SHBA-të hartuan Planin Marshall, plan i cili shihej si shpresë për pajtim ndërmjet shteteve kombëtare për shkak se përmbante një ndihmë financiare në vlerë prej 13 miliard dollarë dhe i cili parashihej të përmbushte objektivat e vëna brenda periudhës 4 vjeçare. Ky plan, objektiv kryesor kishte nxjerrjen e shteteve të Evropës nga kriza e rëndë dhe përqendrimin në ringjalljen e ekonomive, me theks të veçantë të Gjermanisë dhe Francës si dy shtete antagoniste, përkatësisht të dy industrive të thengjillit dhe çelikut. Në këtë drejtim, SHBA-të si promotor të demokracisë dhe zhvillimit ekonomik, gjithashtu ishin të vendosur që përmes ndihmës së ofruar të nxitnin bashkëpunimin ndërmjet shteteve të Evropës me qëllim të relaksimit të marrëdhënieve dhe në anën tjetër përmes këtij bashkëpunimi të

funksionalizimit industrisë ekzistuese me qëllim të shpërndarjes së qymyrgurit në shtetet e Evropës për dy arsye: për të ngrohur ndërtesat dhe për të vënë në funksion fabrikat. Dr. Leri Blend, historian në Fondacionin Xhorxh Marshall thoshte se “Problemi ishte se në Evropën perëndimore shumica e qymyrgurit vjen nga minierat gjermane, të cilat ishin përmblytur pas bombardimeve të rënda. Gjermanët nuk mund t’i hapnin ato miniera dhe Shtetet e Bashkuara do të siguronin pajisjet e duhura. Gjermanët do të punonin në miniera, ndërsa ne do t’i pastronim nga përmblytja, do të rindërtonim shtëpitë e punëtorëve dhe do t’i vaksinonim ata kundër tuberkulozit dhe gjërave të tjera, për t’i krijuar mundësinë të punonin shumë.” Brenda 4 viteve të realizimit të Planit Marshall, u dhanë efektet pozitive të përmirësimit të jetës së qytetarëve, ku prodhimi i përgjithshëm kombëtar i Evropës perëndimore u rrit për 32% e që kjo përbënte një rritje ekonomike afatgjate dhe njëkohësisht sillte stabilitet për Evropën. Megjithatë, përkundër nacionalizmit

¹ Klementin Mile, “15 Pyetje për Bashkimin Evropian”, Ministria e Integrimit, Tiranë, fq. 4



të theksuar ndërmjet shteteve kombëtare, doli në dukje drita e shpresës për të ardhmen e Evropës, si dhe forcimi i konceptit të përafritimit dhe bashkimit të shteteve në një familje evropiane. Së këndejmi, shtetet kombëtare ishin të vendosura që të organizonin një konferencë me pjesëmarrje të gjerë të shteteve dhe në këtë rrafsh u arrit që të organizohej “Kongresi i Evropës i mbajtur në Hagë në Maj 1948 i cili u ndoq prej delegatëve të 16 shteteve evropiane dhe vëzhguesve nga Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja. Aty u diskutuan shumë ide ambicioze, por rezultati konkret i kongresit ishte ideja për krijimin e Këshillit të Evropës. Ky i fundit u zyrtarizua një vit më pas me nënshkrimin në Londër të një statuti prej 10 shtetesh evropiane. Në statut u theksua nevoja për një bashkim më të ngushtë ndërmjet vendeve evropiane që e dëshironin këtë dhe shpalli se objektivat e Këshillit përfshinin veprimin e përbashkët për çështjet ekonomike, sociale, kulturore, shkencore, ligjore dhe administrative, por jo për çështjet e mbrojtjes”². Pra, u krijua një gjendje e re në Evropë për sa i përket integritimit dhe unifikimit të qëndrimeve ndërmjet shteteve. Edhe pse u shënuar kthesa pozitive drejt integritimit rajonal të shteteve kombëtare, dy vendet kryesore si Gjermania dhe Franca nuk ishin edhe aq të kënaqura me arritjet, këto dy shtete ishin në kërkim e sipër të një zgjidhje më afatgjate ndërmjet tyre dhe më gjerë. Francezi i quajtur me emrin Zhan Mone doli në skenë me idenë e tij të guximshme mbi udhëheqjen dhe organizimin e përbashkët të industrisë së thëngjillit (qymyrit) dhe çelikut, kështu duke përfshirë edhe shtetet e tjera në këtë çështje. Kjo

ide gjeti mbështetjen edhe të kolegut të tij Robert Schuman i cili në atë kohë ishte ministër në Qeverinë e Francës dhe i cili e mbështeti fuqishëm këtë propozim ide të Mones në fjalimin e mbajtur me datë 9 maj të vitit 1950. “Ky fjalim jo vetëm që bindi udhëheqësit francez dhe gjerman, por edhe udhëheqësit e Belgjikës, Italisë, Luksemburgut dhe të Hollandës. Të gjitha këto shtete vendosen që t’i bashkojnë industritë e tyre të thëngjillit dhe të çelikut dhe ta formojnë një klub, që ata e quajtën Komuniteti Evropian i Thëngjillit dhe Çelikut (KETHC). Ky Komunitet do të funksiononte për qëllime paqësore dhe do të ndihmonte në rindërtimin e Evropës nga rrënojat e luftës. KETHC-ja u themelua në vitin 1951”³. Pra, klubi në fazën fillestare të përbërjes së saj kishte 6 shtete si: Franca, Gjermania Perëndimore, Italia, Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu.

Pas këtij veprimi, pasuan ngjarje me rëndësi historike, si: “nënshkrimi i Traktatit themelues të Bashkësisë Ekonomike Evropiane (BEE) shpesh i referuar si “Traktati i Romës” më 25 mars 1957 në Romë dhe hyrja në fuqi më 1 janar të vitit 1958; Nënshkrimi i Traktatit themelues të Bashkësisë Evropiane për Energji Atomike (Euratom) u nënshkrua në Romë së bashku me Traktatin për BEE; Akti Unik Evropian (AUE) u nënshkrua në shkurt të vitit 1986 dhe hyri në fuqi më 1 korrik, ndërkaq më 1987 ndryshoi Traktatin e BEE dhe hapi rrugën për formim të tregut unik; Traktati për Bashkimin Evropian u nënshkrua në Mاستriht më 7 shkurt, 1992 dhe hyri në fuqi më 1 nëntor 1993, shpesh i referuar si “Traktati i Mاستrihtit”⁴. Kthesa historike ndodhi me rënien e Murit të Berlinit në vitin 1989, ku u

arrit të ç’rrenjosez ndarja dhe barrikada shumëvjeçare ndërmjet perëndimit dhe lindjes. Me këtë rast, triumfoi blloku perëndimor dhe mbi të gjitha triumfoi demokracia si orientim programor, politik dhe strategjik me në krye Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Duke e parë rrjedhën e bashkëveprimit dhe konsolidimit të klubit, shtetet e tjera të Evropës të cilat konsideroheshin si të varfra krahasuar me pjesën perëndimore të shteteve, shprehën guximin dhe gatishmërinë e tyre që t’i bashkohen klubit. Po ashtu, kjo erdhi edhe si rezultat i suksesit të klubit në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe ngritjes së mirëqenies sociale. Gjatë kësaj periudhe kohore u shënuan të arritura të mëdha në realizimin e projekteve, përfshirë fusha të ndryshme si: mbrojtje të mjedisit, ndërtimin e rrugëve dhe hekurudhave, heqjen e kontrollit të pasaportave në kufi, bashkëpunimi policor ndërmjet shteteve etj. Pra, shikuar në horizont, shtetet përjetuan lirinë e shumë kërkuar dhe aderimi i këtyre shteteve në klub shihej si domosdoshmëri e kohës, ku me këtë rast mundësoi rritjen dhe njëkohësisht ndryshimin e klubit përbrenda konceptit dhe programit të saj. Ky fakt, bëri që klubi në vitin 1992 të ndryshoj emërtimin dhe ta zëvendësoj me emrin Bashkim Evropian (BE).

Së këndejmi, aderimi i shteteve të reja në Bashkimin Evropian kishte disa kritere fundamentale dhe specifike të cilat duhej plotësuar për tu bërë pjesë e familjes së madhe evropiane, pra “Para se një vend të mund t’i bashkohet Bashkimit Evropian, duhet ta ketë një ekonomi funksionale. Po ashtu, vendi duhet të jetë demokratik, me fjalë të tjera,

² Klementin Mile, “15 Pyetje për Bashkimin Evropian”, Ministria e Integritimit, Tiranë, fq. 8

³ Komisioni Evropian “Ta gjurmojmë Evropën”, Drejtorati i Përgjithshëm për Komunikim Publikime 1049 Bruksel, BELGIKË, fq. 30.

⁴ Komisioni Evropian “Si funksionon Bashkimi Evropian”, Udhërrëfyesi juaj për Institucionet e BE-së, Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim Publikimet, B-1049 Bruksel, fq. 4



populli i tij duhet të jetë i lirë të zgjedh se kë dëshirojnë t’i udhëheqë, dhe duhet t’i respektojë të drejtat e njeriut. Të drejtat e njeriut përfshijnë të drejtën për të thënë atë që mendon, të drejtën për të mos u burgosur pa një gjykim të drejtë, të drejtën për të mos u torturuar, si dhe shumë të drejta të tjera të rëndësishme”⁵.

Këto kritere ishin të përcaktuara në Deklaratën e Këshillit Evropian të qershorit të vitit 1993 të njohura si Kriteret e Kopenhagës. Po ashtu, Kriteret e Kopenhagës u përfocuan më tej në Samitin e Këshillit Evropian të mbajtur në Madrid më 1995. Kriteret e Kopenhagës janë rregulla të formuluar nga Këshilli Evropian më 1993, si dhe janë sanksionuar në nenin 6 (1) dhe 49 të Traktatit të BE-së. Tre fushat kryesore që përbëjnë këto kritere janë:

1) Kriteret Politike - Stabilitetin e institucioneve të cilat garantojnë demokracinë, zbatimin e ligjit, të drejtat e njeriut si dhe respektin e mbrojtjen e minoriteteve;

2) Kriteret Ekonomike - Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale, si dhe kapacitetin për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut të BE-së;

3) Kriteret Legjislative - Respektimi i Parimit të Acquis Communautaire⁶;

Këto kritere shërbejnë si udhërrëfyes për shtetet aspirant me qëllim të marrjes përsipër të obligimeve dhe siguruar që shteti i cili aspiro anëtarësimin në Bashkimin Evropian të ketë plotësuar kushtet më kryesore si: garantimin e demokracisë dhe posedimin e institucioneve stabile, shtetin e së drejtës, respektimin e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve njëkohësisht, funksionimin e ekonomisë së tregut, duke sjellë një ekonomi të lirë, stabile dhe konkurrencte me shtetet e rajonit dhe më gjerë, si dhe duke treguar aftësi për të përballuar presionin e konkurrencës së forcave të tregut brenda BE-së, kriteret e adoptimit të kuadrit ligjor “acquis communautaire”, kapacitetet për të

përbushur obligimet që rrjedhin nga statusi i shtetit anëtar për sa i përket integrimit dhe objektivave politike, ekonomike dhe monetare të Bashkimit Evropian.

Më tej, Bashkimi Evropian nuk u ndal së vepruari dhe vazhdoi rrugëtimin drejt thellimit dhe zgjerimit të saj. Në këtë kontekst, aderimi i shteteve të reja dhe reforma institucionale, ishin dy nga elementet të cilat e karakterizojnë këtë organizatë. Këto ndryshime dhe avantazhe vinin në shprehje edhe më shumë me hyrjen në fuqi të traktateve të reja, ku ndër to mund të përmendim: “Traktati i Amsterdimit i cili u nënshkrua më 2 tetor, 1997 dhe hyri në fuqi më 1 maj, 1999. Ky traktat zgjeroi ndarjen e sovranitetit në më shumë fusha duke përfshirë më shumë të drejta të qytetarëve dhe ndërveprim më të afërm mbi politikat sociale dhe ato të punësimi; Traktati i Nicës, i nënshkruar më 26 shkurt 2001, hyri në fuqi më 1 shkurt, 2003. Edhe ky traktat bëri ndryshime traktateve tjera, duke i dhënë orientim sistemit institucional të BE, ashtu që të vazhdojë të funksionojë në mënyrë efektive pas valës së re të pranimit të shteteve-anëtare; Draft Traktati Kushtetues, i cili ishte aprovuar dhe nënshkruar në tetor 2004, por nuk hyri në fuqi sepse nuk u miratua nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së;⁷.

Fare në fund, me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës më 1 dhjetor 2009, “reformimi dhe modernizimi i institucioneve evropiane bëri të mundur promovimin e plotë të objektivave të BE-së në shërbim të qytetarëve dhe shteteve anëtare, si dhe konsolidoi urën lidhëse në mes të qytetarëve dhe projektit evropian, të nisur në fillim të viteve 50 drejt “pajtimit” dhe “unifikimit” të kontinentit evropian”⁸.

⁵ Komisioni Evropian “Ta gjurmojmë Evropën”, Drejtorati i Përgjithshëm për Komunikim Publikime 1049 Bruksel, BELGIJKË, fq. 33

⁶ <http://www.dados-europe.org/int/grundkurs5neu/Chronologie.htm>, autor Prof. Dr. Wolfgang Schumann;

⁷ Komisioni Evropian “Si funksionon Bashkimi Evropian”, Udhërrëfyesi juaj për institucionet e BE-së, , Drejtorata e Përgjithshme për Komunikim Publikimet, B-1049 Bruksel, fq 4;

⁸ Ministria e Integrimit Evropian “Versioni i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian”, Tiranë, Republika e Shqipërisë, fq.6;



STRUKTURA INSTITUCIONALE E BASHKIMIT EVROPIAN DHE ROLI I TYRE

Edhe në ditët e sotme, Bashkimi Evropian vazhdon të konsiderohet si model unik në tërësinë e saj, me një kompleksitet për sa i përket organizimit, funksionimit dhe strukturës institucionale. Këtë fakt më së miri e argumenton përbërja e shteteve anëtare të BE-së të cilat perceptohen në kontekstin real si

shtete me sisteme të ndryshme të qeverisjes, diversitet gjuhësor, kulturor, racor, religjioz dhe gjeografik, si dhe nacionalizëm të theksuar. Po ashtu, këto shtete në momentin e anëtarësimit të tyre, kanë vendosur të bartin një pjesë të sovranitetit në organizatën e quajtur BE, me qëllim që në politikat globale të kenë ndikim dhe të rrisin autoritetin në nivelin global, si dhe të përmbushin objektivat e synuara, ndërkaq pjesën tjetër të sovranitetit ta mbajnë brenda kornizës shtetërore.

Pra, në këtë rrafsh, në hapat e parë të konsolidimit, Bashkimi Evropian u krijua nga Traktati i Mاستrihtit, traktat i cili kishte krijuar dhe ngritur 3 lloje të shtyllave të njohura si⁹:

- 1) Komuniteti Evropian (shtylla e parë) - Për detyrë kishte zhvillimin e harmonizuar, të balancuar dhe të qëndrueshëm të aktiviteteve ekonomike, nivelin e lartë të punësimit dhe mbrojtjes sociale, barazisë për burrat dhe gratë;
- 2) Politika e Përbashkët dhe e Jashtme e Sigurisë (shtylla e dytë) - Shtetet Anëtare ishin të gatshme të mbështesin këtë politikë në mënyrë aktive dhe pa rezervë në frymën e besnikërisë dhe solidaritetit të ndërsjellë. Objektivat e tij ishin: që të

ruhen vlerat e përbashkëta, interesat themelore, pavarësia dhe integriteti i Bashkimit në konformitet me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, për të forcuar sigurinë e Bashkimit në të gjitha mënyrat, për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar, zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

- 3) Bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme (shtylla e tretë) – Objektivi i Bashkimit ishte për të zhvilluar veprime në këto zona me metoda ndërqeveritare si dhe për t’u dhënë qytetarëve një nivel të lartë të sigurisë brenda një zone të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë duke mbuluar fushat si: rregullat dhe ushtrimin e kontrolleve për kalimin e kufijve të jashtëm të Komunitetit; luftimin e terrorizmit, krimeve të rënda, të drogës, trafikimit dhe mashtrimet ndërkombëtare; bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale dhe civile; krijimin e një Zyrës Evropiane të Policisë (Europol) me një sistem për shkëmbimin e informacionit mes forcave policore kombëtare; kontrollin e emigracionit të paligjshëm; politikë të përbashkët të azilit.



SHTYLLA E PARË Të tre Komunitetet Evropiane

- EC
- EURATOM
- Shtylla e parë është përgjegjës për tregun e përbashkët dhe lirinë e lëvizjes përtej kufijve. Ajo gjithashtu duket pas bashkimit dhe çështje të tilla si bujqësia, mjedisit dhe konkurrencës ekonomike dhe monetare. Në këtë shtyllë, ndryshe nga dy të tjerat, shtetet anëtare kanë hequr dorë prej një pjesës së sovranitetit dhe institucionet e BE mund të veprojnë në mënyrë të pavarur nga qeveritë kombëtare.

SHTYLLA E DYTË Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët

- Politika e Jashtme
- Paqeruajtës
- Të Drejtat e Njeriut
- Demokracia
- Ndihma e huaj
- Politika e Sigurisë
- Korniza e Sigurimit të Evropës
- Aspektet financiare të mbrojtjes
- Në shtyllën e dytë, shtetet anëtare kanë për qëllim për të mbajtur qëndrime të përbashkëta dhe të marrin veprime të përbashkëta në çështjet e jashtme dhe të sigurisë.

SHTYLLA E TRETË Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor në çështjet penale

- Bashkëpunimi Policor
- Lufta kundër racizmit
- Lufta kundër krimit të organizuar
- Lufta kundër drogës
- Lufta kundër terrorizmit
- Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore
- Objektivi i shtyllës së tretë është që të integrojë politikën e shteteve anëtare të azilit dhe emigracionit, doganat, drogës dhe krimit.

Fig. 2. Shtyllat e Bashkimit Evropian

⁹ European Parliament, “ Fact Sheets on the European Union(2014 edition)”, Luxembourg: Publications Office of the European Union 2013, fq 18;

Gjithashtu, pas 7 viteve të funksionimit të këtyre shtyllave, përkatësisht 11 viteve, këto shtylla pësuan disa ndryshime dhe plotësime mbas hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdimit të vitit 1999 dhe Traktatit të Nicës të vitit 2003. Transferimi i politikave mbi azilin, migracionin dhe bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile përbëjnë një nga ndryshimet (Traktati i Amsterdimit), ndërkaq, shtylla e tretë u riemërua Policia dhe Bashkëpunimi Gjyqësor në Çështjet penale (PJCC), kurse termi Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme ende përdoret për të mbuluar shtyllën e tretë dhe fushat e transferuara. Pra, këto ndryshime u bënë me qëllim të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe ndryshimit të saj drejt funksionimit dhe mënyrës më efikase dhe efektive të veprimit. Çfarë e bënë më të rëndësishme dhe më karakteristike Bashkimin Evropian është struktura e saj institucionale për

të cilën njohësit e integrameve evropiane e shohin si strukturë e cila nuk krahasohet me asnjë nga kategoritë juridike, thjeshtë nuk ka një ndarje tradicionale të pushteteve: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Duke u bazuar në nenin 13 (paragrafi 1) të Traktatit të Lisbonës (TBE), ky nen përcakton qartë kornizën institucionale ku thekson se “Bashkimi ka një kuadër institucional që ka si qëllim të promovojë vlerat e tij, të çojë përpara objektivat e tij, t’u shërbejë interesave të tij, të qytetarëve të tij dhe të Shteteve Anëtare dhe të sigurojë njëtrajshmërinë, efektshmërinë dhe vijimësinë e politikave dhe masave të tij. Institucionet e Bashkimit janë: Parlamenti Evropian, Këshilli Evropian, Komisioni Evropian (i quajtur më poshtë “Komisioni”), Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, Banka Qendrore Evropiane, Gjykata e Audituesve”¹⁰.

Shikuar në këndvështrim të përgjithshëm, të gjitha këto institucione bashkërisht bëjnë hartimin dhe miratimin e politikave e ligjeve të cilat gjejnë zbatim në BE. Po ashtu, bashkëpunimi institucional bëhet edhe më i lehtë për shkak të përcaktimit të kompetencave që Traktatet u japin. Për sërë afërmi, këtë çështje e shtjellojmë në mënyrë konkrete nën 13 (paragrafi 2) i Traktatit të Lisbonës (TBE) ku thotë se “Secili institucion vepron brenda kufijve të kompetencave që u japin Traktatet dhe në përputhje me procedurat, kushtet dhe objektivat që përcaktohen në to. Institucionet praktikojnë bashkëpunim të sinqertë të ndërsjellë”¹¹. Për më tepër, në vijim do të shtjellojmë radhazi secilin institucion të BE-së veç e veç lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre në kontekstin e traktateve të BE-së, si dhe raportet brenda institucionale.

INSTITUCIONET E BASHKIMIT EVROPIAN




Fig.3. Struktura Institucionale e Bashkimit Evropian

¹⁰ Ministria e Integrimit Evropian “ Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, fq.25;

¹¹ Ministria e Integrimit Evropian “ Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, fq.25;



PARLAMENTI EVROPIAN



Historia e themelimit të Parlamentit Evropian korrespondon me vetë krijimin e Bashkimit Evropian qysh nga Traktatet e para themeltare (1950). Pra, Parlamenti Evropian ka një traditë mbi 50 vjeçare të funksionimit dhe zhvillimit të demokracisë. Shquhet për kontrollin politik që mbanë në raport me aktivitetet dhe veprimet e Bashkimit Evropian, si dhe luan një rol të pakontestueshëm në procedurën legjislative.

Karakteristikë e veçantë e Parlamentit Evropian është se selia e tij ndodhet në tre vende: Strasburg, Bruksel dhe Luksemburg. Në këtë kontekst, “Parlamenti Evropian mbledhjet plenare i mban në Strasburg, ndërsa mbledhjet tjera në Bruksel. Parlamenti ka 10 (dhjetë) komisione të cilat i përgatisin mbledhjet plenare, si dhe disa grupe politike që zakonisht takohen në Bruksel. Sekretariati gjeneral i Parlamentit gjendet në Luksemburg dhe Bruksel”¹². Sot, Parlamenti Evropian është njëri nga organet kryesore të bashkë-vendimarrjes së bashku me

Këshillin e BE-së. Nga viti 1979 deri në vitin 1993, në punën dhe procedurat legjislative, Parlamenti Evropian kishte më shumë rolin dhe të drejtën e bashkëpunimit, pëlqimit dhe bashkërendimit. Mirëpo, me hyrjen në fuqi të Traktatit të Mastrohittit të vitit 1993 dhe Traktateve të tjera vijuese, Parlamentit Evropian filloi t’i rritej roli dhe kompetencat e tij, ku potencialisht me Traktatin e Lisbonës, parlamenti arriti të ketë barasvlerë dhe fuqi në procesin e bashkë-vendimarrjes së bashku me Këshillin e BE-së.

Vlen të theksohet se modeli i sistemit elektoral në BE është sistemi proporcional i përfaqësimit. Çdo qytetar i BE-së e posedon të drejtën e votës, mirëpo si votues i regjistruar. Deputetët e Parlamentit Evropian zgjedhen nga qytetarët e BE-së në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me votim të përgjithshëm “për çdo 5 vite”¹³, ndërkaq përcaktimi i ulëseve në parlament bëhet mbi bazën e numrit të popullsisë së shteteve anëtare. Numri i përgjithshëm i deputetëve që e përbëjnë Parlamentin Evropian të 28 shteteve anëtare të BE-së është 751.

Gjithashtu, pozicionimi i deputetëve në Parlamentin Evropian nuk bëhet sipas përfaqësimit të shteteve prej nga vijnë, mirëpo sipas grupimeve politike të cilat janë të profilizuara dhe të cilat i takojnë të njëjtës ideologji dhe programi politik. Të njohura janë 7 grupe politike në Parlamentin Evropian si: “Partia Popullore Demokratike (Demokratët Kristianë dhe Demokratët Evropianë), Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve Socialistë për Evropë, Konservatorët dhe Reformistët Evropian, Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropë, E Majta e Bashkuar Evropiane/E Majta e Gjelbër Nordike, Të Gjelbrit/Aleanca e Lirë Evropiane, Evropa e Lirisë dhe Demokracisë”¹⁴.

Zgjedhjet e fundit evropiane të mbajtura me datë 22-25 maj 2014 kanë dhënë mundësinë qytetarëve (votuesve të regjistruar) “të ndikojnë në kursin e ardhshëm politik të Bashkimit Evropian”¹⁵, kështu duke zgjedhur të preferuarit e tyre.

Në vijim është paraqitur skema lidhur me numrin e ulëseve të deputetëve dhe përqindjes së shprehur të grupeve politike në Parlamentin Evropian:

¹² Paskal Fonten, “Evropa në 12 leksione”, Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim, Publikime B-1049 Bruksel, fq 19;

¹³ Ministria e Integrimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, fq.26

¹⁴ The European Union explained “How the European Union Works”. European Commission, Directorate-General Communication Publications, 1049 Brussels, Belgium, fq. 10;

¹⁵ <http://www.europarl.europa.eu/portal/en> dhe <http://www.results-elections2014.eu/en/election-results-2014.html> përshtatur nga autori i udhëzuesit;



Fig. 4. Numri dhe përqindja e ulëseve të deputetëve të çdo grupimi politik (rezultatet nga zgjedhjet e evropiane të mbajtura me datë 22-25 Maj 2014)

Grupimi i parë politik nga këto zgjedhje ka dalë Partia Popullore Demokratike (Demokratët Kristianë dhe Demokratët Evropianë) me gjithsejtë 221 ulëse (29.43%), grupimi i dytë politik Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve Socialistë për Evropë me gjithsejtë 191 ulëse (25.43%), pasuar nga Konservatorët dhe Reformistët Evropian me 70 ulëse (9.32%), Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropë me 67 ulëse (8.92%), e Majta e Bashkuar Evropiane/e Majta e Gjelbër Nordike me 52 ulëse (6.92%), të Gjelbrit/Aleanca e Lirë Evropiane me 50 ulëse (6.66%), Evropa e Lirisë dhe

Demokracisë me 48 ulëse (6.39%) dhe të tjerët. Me anëtarësimin e Kroacisë në BE (1 korrik 2013), Parlamenti Evropian kishte në total 766 deputet, ndërkaq nga zgjedhjet e majit të vitit 2014 e tutje, Parlamenti Evropian do të ketë 751 deputet. Se çfarë kompetenca dhe përgjegjësi ka Parlamenti Evropian si organ përfaqësues i qytetarëve dhe me legjitimitet demokratik, këtë më së miri e definojnë Traktati i Lisbonës (TBE), neni 14, më pas neni 223 deri tek neni 234, si dhe neni 314. Parlamenti Evropian kryen detyra me rëndësi bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë që ka: bënë

shqyrtimin dhe miratimin e legjislacionit evropian, miraton buxhetin e BE-së, ushtron kontroll demokratik mbi institucionet e tjera të BE-së duke ngritur komisione hetimore. Pra, të gjitha këto kompetenca dhe përgjegjësi që ka Parlamenti Evropian, bazën e kanë në Traktatin e Lisbonës, veçanërisht në nenin 14 (paragrafi 1) ku përcakton se “Parlamenti Evropian ushtron bashkërisht me Këshillin funksione legjislativ dhe buxhetore. Parlamenti ushtron funksione të kontrollit politik dhe të konsultimit, sikurse parashikohet në Traktatet. Ai zgjedh Presidentin e Komisionit”¹⁶.

¹⁶ Ministria e Integrimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, fq.25;



Roli i Parlamentit Evropian është mjaftë domethënës në miratimin e ligjeve, mbikëqyrjen demokratike dhe fuqinë e parasë (buxhetit të BE-së).

Përveç këtyre përgjegjësiëve, Parlamenti Evropian miraton marrëveshje ndërkombëtare të rëndësishme si anëtarësimi i ndonjë vendi në BE dhe marrëveshjet e tregtisë dhe asociimit midis BE-së

dhe vendeve të tjera.

Sa i përket çështjes së mbajtjes së mbledhjeve, është karakteristike se Parlamenti Evropian (bazuar në nenin 229 të TFBE-së) “zhvillon një seancë vjetore. Ai mbledhet, pa pasur nevojë të thirret, të martën e dytë të muajit mars”¹⁷. Gjithashtu, krahas kësaj “Parlamenti Evropian mund të mbledhet në seancë të pjesshme të jashtëzakonshme me

kërkesën e një shumice të deputetëve që e përbëjnë ose me kërkesën e Këshillit ose të Komisionit”¹⁸.

Në këtë kontekst, roli dhe fuqia e Parlamentit Evropian është rritur dhe përforcuar nga Traktati në Traktat, kështu duke e bërë organ të barasvlershëm dhe kryesor bashkë me Këshillin e BE-së.

Këshilli EVROPIAN



Selia e Këshillit Evropian ndodhet në Bruksel

Historia e Këshillit Evropian daton që nga vitet e para të themelimit të Bashkimit Evropian, ndërkaq nga vitet e 70-ta fillon së funksionuari duke mbajtur mbledhje të rregullta për çdo 6 muaj. Këto mbledhje ndryshe janë të njohura edhe si Samite. Konsiderohet si akter kyç i integrimit evropian dhe se fuqizimin dhe rolin e tij si institucion e arrin në vitin 1993

(pothuajse ngjashëm sikurse Parlamenti Evropian), ndërkaq në Traktatin e Lisbonës, Këshilli Evropian si organ arrin të njihet se “ zyrtarisht është ekuivalent me organet e tjera”¹⁹. Këshilli Evropian përfaqëson nivelin më të lartë politik ndërmjet shteteve anëtare të BE-së. Varësisht se si i kanë të rregulluar sistemet e qeverisjes

(shtetet anëtare të BE-së), këto shtete përfaqësohen në mënyra të ndryshme, si me: president, kryeministër dhe kancelar. Po ashtu, Këshilli Evropian përfaqësohet nga Presidenti i tij dhe nga Presidenti i Komisionit Evropian. Politikë prioritare apo detyrë parësore e Këshillit Evropian është se nëse nuk parashihet ndryshe me traktat

¹⁷ Ministria e integrimit Evropian “ Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian” , MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, fq.145;

¹⁸ Ministria e integrimit Evropian “ Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian” , MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë,po aty fq.145;

¹⁹ Prof.Dr.Blerim Reka, Prof.Dr.Otmar Holl, Prof.Dr. Ylber Sela, “Institucionet dhe Politikat e Unionit Evropian”,Botues Forumi për Shoqëri, Shkencë dhe Kulturë “ Universitas” Tetovë 2010, fq 24;



“udhëheqësit vendosin me konsensus mbi drejtimin e përgjithshëm dhe prioritetet e Bashkimit, si dhe sigurojnë shtysën e domosdoshme për zhvillimin e saj”²⁰.

Traktati i Lisbonës në domenin e tij ka paraparë kompetenca dhe përgjegjësi për sa i përket funksionimit të Këshillit Evropian. Në mënyrë të precizuar janë përcaktuar qartë këto kompetenca dhe përgjegjësi në nenet: 15, 26, 27, 42(2) të Traktatit të Bashkimit Evropian(Traktati i Lisbonës).

Neni 15 paragrafi 3 i Traktit të Lisbonës (TBE) përcakton se: “Këshilli Evropian i thirrur nga Presidenti i tij, mbledhet dy herë çdo gjashtë muaj. Kur e kërkon rendi i ditës, anëtarët e Këshillit Evropian mund të vendosin që të mbështeten secili prej tyre nga një ministër dhe, në rastin e Presidentit të Komisionit, nga një anëtar i Komisionit. Kur e kërkon situata, Presidenti thërret një mbledhje të posaçme të Këshillit Evropian”²¹. Paragrafi 5 i nenit 15 të Traktit të Lisbonës (TBE) përcakton se: “Këshilli Evropian e zgjedh Presidentin e tij me shumicë të cilësuar, për një mandat prej dy vjet e gjysmë, me të drejtë rrizgjedhjeje një herë. Në rast të një pengese apo shkeljeje të rëndë, Këshilli Evropian mund t’i japë fund mandatit të Presidentit duke ndjekur të njëjtën procedurë”²².

Kurse neni 26 paragrafët 1, 2 dhe 3

të Traktatit të Lisbonës (TBE), Këshillit Evropian i jep kahe drejtë marrjes së veprimeve të planifikuara duke e bërë edhe më gjithëpërfshirës dhe më faktorizues në udhëheqjen dhe drejtimin e politikave të Bashkimit Evropian. Neni dhe paragrafët në fjalë përcaktojnë se Këshilli Evropian “identifikon interesat strategjikë të Bashkimit, vendos objektivat dhe jep orientimet e përgjithshme të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, duke përfshirë çështjet që kanë rrjedhoja për mbrojtjen. Ai miraton vendimet e nevojshme. Nëse e kërkojnë zhvillimet ndërkombëtare, Presidenti i Këshillit Evropian thërret një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit Evropian për të caktuar drejtimet strategjike të politikës së Bashkimit përballë zhvillimeve të tilla”²³;

Megjithatë, Këshilli Evropian njihet edhe për detyra të tjera me të cilat është i ngarkuar, si: “harton politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurimit dhe merr vendimet e nevojshme për përcaktimin dhe zbatimin e saj mbështetur në orientimet e përgjithshme dhe drejtimet strategjike që ka përcaktuar Këshilli Evropian. Këshilli dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit garantojnë unitetin, qëndrueshmërinë dhe

efektshmërinë e veprimit të Bashkimit”²⁴.

Ndërkaq, neni 27, paragrafi 1 i Traktatit të Lisbonës (TBE), flet për përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë i cili shihet si kontribuues, siguroes dhe garantues i politikës së jashtme të Bashkimit Evropian. Më tej, neni në fjalë specifikon se “Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, i cili drejton Këshillin për Punët e Jashtme, kontribuon me propozimet e tij për hartimin e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit dhe garanton zbatimin e vendimeve që miraton Këshilli Evropian dhe Këshilli”²⁵.

Pra, në hapin final, Këshilli Evropian shihet si organ i pa kontestueshëm dhe me ndikim në Bashkimin Evropian. Edhe nuk ka kompetenca legjislative, Këshilli Evropian është epiqendër e drejtimit të politikës së BE-së, zgjidhës i konflikteve, aktorë në ndryshimet e Traktatit dhe në procesin e zgjerimit, përfaqësues i politikës së jashtme pa ia cenuar kornizën e kompetencave Përfaqësuesit të Lartë për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë.

²⁰ The European Union explained “ Hoë the European Union Eörks”. European Commission, Directorate-General Communication Publications, 1049 Brussels, Belgium, fq. 12;

²¹ Ministria e integrimit Evropian “ Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian” , MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë,po aty fq.26;

²² Ministria e integrimit Evropian “ Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian” , MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë,po aty ;

²³ Ministria e integrimit Evropian “ Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian” , MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë,fq.34;

²⁴ Ministria e integrimit Evropian “ Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian” , MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty;

²⁵ Ministria e integrimit Evropian “ Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian” , MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty;



KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN



Këshilli i BE-së, njëjtë sikurse Parlamenti Evropian, fillet e para të themelimit të saj i ka në traktatet themeltare të viteve të 50-ta. Këshilli i Bashkimit Evropian i njohur si Këshilli i Ministrave është organ kryesor vendimmarrës në hierarkinë institucionale të BE-së. Neni 16, paragrafi 1 i Traktatit të Lisbonës (TBE) përcakton se “Këshilli ushtron bashkërisht me Parlamentin Evropian funksione legjislative dhe buxhetore. Këshilli kryen funksione të politikë bërjes dhe bashkërendimit, sikurse parashikohen në Traktatet”²⁶.

Edhe çështja e përfaqësimit të shteteve anëtare në Këshill është e rregulluar dhe baras vlerësuar mirë. Në këtë drejtim, çdo shtet anëtar i BE-së e dërgon një përfaqësues (ministër) në Këshill”. Pjesëmarrja e ministrit të shtetit anëtar në mbledhjet e Këshillit bëhet duke u bazuar në agjendën e caktuar. Po qe se në agjendë për rend të ditës është përcaktuar diskutimi për politikën e mjedisit apo politikën bujqësore, pjesëmarrës duhet të jetë ministri i mjedisit respektivisht ministri i bujqësisë. Në mbledhjet e Këshillit të BE-së diskutohen dhe zhvillohen çështje me rëndësi, ku nga këto mbledhje ministrat nxjerrin vendime dhe kalojnë ligje. Kjo do të thotë që ministrat janë të zgjedhur nga shtetet anëtare, të cilat shtete i

japin autoritet ministrave për të vepruar. Gjithashtu, kjo mundëson dhe siguron që vendimet të cilat i nxjerr Këshilli të kenë legjitimitet demokratik. Presidenca e Këshillit të BE-së është me rotacion çdo 6 muaj, kurse mbledhjet mbahen në Bruksel (përveç muajve prill, qershor dhe tetor), ndërkaq mbledhjet të cilat nuk mbahen për këta muaj në Bruksel mbahen në Luksemburg. Këshilli i BE-së ushtron kompetencat e tij bazuar në nenin 16 të Traktatit të

- 1 Të kalojë ligjet evropiane. Në shumicën e fushave ajo kryen funksione legjislative së bashku me Parlamentin Evropian;
- 2 Koordinon politikën e Shteteve Anëtare, p.sh. në fushën ekonomike;
- 3 Zhvillon politikën të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së BE-së, bazuar në udhëzimet e vendosura nga Këshilli Evropian;
- 4 Përfundon (përmbyll) marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet BE-së dhe një ose më shumë shteteve ose organizatave ndërkombëtare; si dhe Miraton buxhetin e BE-së së bashku me Parlamentin Evropian.
- 5

Lisbonës (Traktati i Bashkimit Evropian) dhe nenet 237-243 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian. Këshilli i BE-së ka 6 përgjegjësi (detyra) kyçe, ku në fillim janë njohur 5 prej tyre, ndërkaq më vonë është plotësuar edhe me 1 përgjegjësi²⁷:

Ndërkaq, përgjegjësia e 6 ka të bëjë me “Koordinimin e bashkëpunimit në mes të gjykatave kombëtare dhe forcave të policisë në çështje penale (çështje si liria, siguria dhe ligji)”²⁸.

Në këtë kuadër të kompetencave, Këshilli i BE-së së bashku me Parlamentin Evropian bashkëvendosin në ligjvënien evropiane. Roli i Komisionit Evropian është i pakontestueshëm në këtë drejtim, ngase konsiderohet si promotore e propozimeve për ligje të reja dhe me këtë rast e plotëson ciklin e lëvizjes ndërmjet Këshillit të BE-së dhe Parlamentit Evropian. Pra, kjo determinon procesin e vendimmarrjes së Këshillit të BE-së dhe së këndejmi e obligon të mbajë pozicion të ekuilibruar në raport me Parlamentin Evropian.

Në çështjen e koordinimit të politikave, Këshilli ka dëshmuar se ka arritur konsolidimin e plotë për sa i përket politikave në fushën e ekonomisë. Me këtë rast, është krijuar një praktikë e mirë e koordinimit dhe ndërmarrjes së veprimeve sidomos në çështjen e krijimit të vendeve të reja të punës, përmirësimit të sistemit arsimor, shëndetësor dhe social.

Sa i përket zhvillimit të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së BE-së, Këshilli ofron mundësinë e shteteve anëtare të kenë

²⁶ Ministria e Integrimit Evropian “ Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, fq.27;

²⁷ The European Union explained “ How the European Union Works”. European Commission, Directorate-General Communication Publications, 1049 Brussels, Belgium, fq. 15;

²⁸ http://www.pharos-online.org/download/eu_simulation_game/alb/Keshilli_i_Bashkimit_Evropian, fq1;




bashkëpunim ndërshtetëror. Me qëllim të parandalimit të krizave dhe ofrimit të sigurisë në Evropë dhe më gjerë, Bashkimi Evropian ka krijuar “Trupat e ndërhyrjes së shpejtë, një ushtri ndërkombëtare, ushtarakët e të cilës mbeten pjesë e ushtrive kombëtare dhe janë nën komandon kombëtare. Funkzioni i tyre kufizohet në detyra humanitare dhe misionet shpëtimi, masa paqeruajtëse dhe detyra të tjera për zgjidhjen e krizave. Kështu p.sh. në vitin 2003 BE realizoi një operacion ushtarak me emrin Artemis në Republikën Demokratike të Kongos si dhe në vitin 2004 filloi një mision paqeruajtës nën emrin Althea Bosnje-Hercegovinë”²⁹.

Nënshkrimi i marrëveshjeve brenda shteteve anëtare të BE-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare përbën elementin crucial të zhvillimit ekonomik duke përfshirë fusha si tregtia, shkenca, teknologjia, transporti, peshkimi, tekstili etj. Këtë e dëshmon më së miri bashkëpunimi i thelluar në fushën e ekonomisë ndërmjet BE-së dhe Kinës, si dy tregje me përmasa të mëdha të shkëmbimit tregtar.

Buxheti i Bashkimit Evropian miratohet çdo vit nga bashkëvendimmarrësit Këshill i BE-së dhe Parlament Evropian. Tek koordinimi i bashkëpunimit në mes të gjykatave kombëtare dhe forcave të policisë në çështjet penale, përfshirë edhe çështje e tjera si liria, siguria dhe ligji, përbëjnë aktin më të lartë të ofrimit të lirisë së qytetarëve për t’u mundësuar të

jetojnë dhe punojnë lirshëm, kështu duke u ofruar siguri dhe garanci të plotë. Përveç detyrave (përgjegjësi) të lartcekura, Këshilli i BE-së ka 10 konfigurime të ndryshme³⁰:



I kryesuar nga Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri:

- 1 Punëve të Jashtme

I kryesuar nga Shteti Anëtar që mban Presidencën e Këshillit:

- 1 Çështje të përgjithshme;
- 2 Çështjeve Ekonomike dhe Financiare;
- 3 Drejtësia dhe Punët e Brendshme;
- 4 Punësimi, Politikat Sociale, Shëndeti dhe Çështjet e Konsumatorit;
- 5 Konkurrueshmëria (Tregu i Brendshëm, Industria, Kërkimi dhe Hapësirë);
- 6 Transportit, Telekomunikacionit dhe Energjisë;
- 7 Bujqësia dhe Peshkataria;
- 8 Mjedis;
- 9 Arsimi, Rinia, Kultura dhe Sporti;

Lirisht mund të themi se Këshilli i BE-së në opusin e tij konsiderohet si konglomerat i posedimit të shumë kompetencave përmes së cilave ngrit lartë veprimtarinë dhe drejtimin e Bashkimit Evropian në rrugëtim më të fortë dhe më të qëndrueshëm.



KOMISIONI EVROPIAN

Historiku i themelimit të Komisionit Evropian është i njëjtë sikurse i Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së, bazën e themelimit e ka në traktatet themelare të vitit 1950. Komisioni Evropian është institucion i pavarur, jo i ndikuar politikisht, i cili përfaqëson dhe promovon vlerat e përbashkëta të Bashkimit Evropian. Konsiderohet si lëvizësi kryesor i institucioneve të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, është i njohur si ekzekutivi i BE-së i cili propozon ligje, politikat e marrëveshjeve, si dhe promovon Bashkimin Evropian. Kolegji i komisionarëve përbëhet nga përfaqësuesit e secilit shtet anëtar të BE-së. Selia e Komisionit Evropian ndodhet në Bruksel.

Komisioni Evropian bazën ligjore e ka në nenin 17 të Traktatit të Lisbonës (TBE) dhe në nenet 234, 244-250, 290 dhe 291 të Traktatit të Lisbonës (TFBE). Ekziston një gamë e gjerë e përgjegjësi që i takojnë Komisionit Evropian dhe këtë më së miri e definon neni 17, paragrafi 1 i Traktatit të Lisbonës(TBE) ku precizon se “Ai siguron zbatimin e Traktateve dhe të masave të miratuara nga institucionet në zbatim të tyre. Ai mbikëqyr zbatimin e së drejtës së Bashkimit nën kontrollin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Ai zbaton buxhetin dhe administron programet. Ai ushtron funksione bashkërenduese, ekzekutive dhe administruese, që parashikohen në Traktatet. Me përjashtim të politikës së përbashkët të jashtme dhe të

²⁹ http://www.pharos-online.org/download/eu_simulation_game/alb/Keshilli_i_Bashkimit_Evropian, fq. 2;

³⁰ The European Union explained “How the European Union Works”. European Commission, Directorate-General Communication Publications, 1049 Brussels, Belgium, fq. 15;



sigurimit, dhe të rasteve të tjera të parashikuara nga Traktatet, ai siguron përfaqësimin e jashtëm të Bashkimit. Ai çel programimin vjetor dhe shumëvjeçar të Bashkimit, me qëllim arritjen e marrëveshjeve ndërinstitucionale”³¹.

Pra, qasja dhe përfshirja e Komisionit Evropian është pothuajse në çdo fushë dhe përgjegjësi me rëndësi të BE-së, duke u nisur nga sigurimi i zbatimit të traktateve e deri tek arritja e marrëveshjeve ndërinstitucionale.

Sa i përket akteve legislative të BE-së dhe të drejtës për të iniciuar dhe propozuar ato, këto akte bazuar në nenin 17, paragrafi 2 “Mund të miratohen vetëm me propozim të Komisionit, nëse nuk parashikohet ndryshe nga Traktatet. Aktet e tjera miratohen me propozim të Komisionit, kur këtë e parashikojnë Traktatet”³². Në këtë drejtim, e drejta për të iniciuar propozime për legjislacion të ri të BE-së i takon Komisionit Evropian, dhe se kjo vijë si rezultat i marrjes parasysh të sfidave dhe nevojave të cilat shfaqen në BE dhe për të cilat kërkohet veprim konkret me qëllim të dhënies së përgjigjes për problemet dhe tejkalimit të tyre në mënyrë sa më

efikase dhe efektive, kështu duke mbrojtur interesat e përgjithshme të qytetarëve të BE-së.

Në çështjen e mandatit të Komisionit dhe zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit, neni 17 paragrafi 3 ka paraparë se “Mandati i Komisionit është 5 vjet” kurse, “Anëtarët e komisionit zgjedhën në bazë të kompetencave të tyre të përgjithshme dhe angazhimit për Evropën, dhe janë persona për pavarësinë e të cilëve nuk ka asnjë dyshim”³³.

Në këtë kontekst, Komisionarët e BE-së janë të njohur për pozita politike që kanë mbajtur në vendet prej nga vijnë dhe zgjedhja e tyre ndërlidhet me kontekstin politik dhe të arriturave të tyre. Por që, nuk duhet të harrojmë se komisionarët tërë angazhimin e tyre e vënë në dispozicion dhe interes të BE-së, kështu duke përjashtuar marrjen e udhëzimeve nga qeveritë e shteteve kombëtare.

Është interesante emërimi dhe përbërja e komisionarëve (numri i komisionarëve të shteteve anëtare), ku në mënyrë specifike këtë e precizon neni 17 paragrafi 4 dhe 5 i Traktatit të Lisbonës (TBE) në dy periudha kohore:

Në periudhën e parë “Komisioni i

emëruar nga data e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës deri më 31 tetor 2014, përbëhet nga një shtetas i secilit Shtet Anëtar, duke përfshirë edhe Presidentin e tij dhe Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, i cili është njëri prej Zëvendës-presidentëve të tij”³⁴, pra, shtetet anëtare të BE-së përfaqësohen me nga 1 komisionar deri më 31 tetor 2014.

Ndërkaq në periudhën e dytë (të ardhshme) parashihen ndryshime për sa i përket përfaqësimit të shteteve anëtare në Komision. Janë një varg elementesh të cilat e sjellin këtë ndryshim dhe këtë çështje më së miri e definojnë paragrafi i 5-të ku thekson se “Duke filluar nga data 1 nëntor 2014, Komisioni do të përbëhet nga një numër anëtarësh, duke përfshirë Presidentin e tij dhe Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, që përkon me dy të tretat e numrit të Shteteve Anëtare, nëse Këshilli Evropian, me unanimitet, nuk vendos ta ndryshojë këtë numër. Anëtarët e Komisionit zgjidhen mes shtetasve të Shteteve Anëtare, në bazë të një sistemi i cili respekton rotacionin e barabartë të Shteteve Anëtare, duke pasqyruar

³¹ Ministria e Integrimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, fq.28;

³² Ministria e Integrimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty;

³³ Ministria e Integrimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty fq.28;

³⁴ Ministria e Integrimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty, fq.28;

gamën demografike dhe gjeografike të gjithë Shteteve Anëtare. Ky sistem krijohet me unanimitet nga Këshilli Evropian, në përputhje me nenin 244 të Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Evropian³⁵.

Mënyra e zgjedhjes së Presidentit të Komisionit Evropian, listës së propozuar për anëtarë të Komisionit dhe përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit, kalon nëpërmjet një ciklit mjaft kompleks ndërmjet Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian, si dy institucione të BE-së. Se si fillon dhe mbaron ky proces, neni 17 paragrafi 7 i Traktatit të Lisbonës (TBE) e parasheh se “Duke marrë në konsideratë zgjedhjet për Parlamentin Evropian dhe pasi zhvillon konsultimet e duhura, Këshilli Evropian, duke vepruar me shumicë të cilësuar, i propozon Parlamentit Evropian një kandidat për Presidentin e Komisionit. Këtë kandidat e zgjedh Parlamentin Evropian me shumicën e deputetëve që e përbëjnë. Nëse nuk merr shumicën e nevojshme, Këshilli Evropian, duke vepruar me shumicë të cilësuar, brenda një muaji propozon një kandidat të ri, të cilin e zgjedh Parlamentin Evropian duke ndjekur të njëjtën procedurë”³⁶.

Gjithashtu, miratimi i listës së propozuar për anëtarë të Komisionit ka një rrjedhë procedurale, e që faktor kyç në përcaktimin e tij është Këshilli së bashku me Presidentin e zgjedhur të Komisionit Evropian, më tej neni 17 paragrafi 7 i Traktatit të Lisbonës (TBE) përcakton se “Këshilli, në marrëveshje me Presidentin e zgjedhur, miraton listën e personave të tjerë të cilët i propozon për emërim si anëtarë të Komisionit. Ata përzgjidhen në bazë të propozimeve që bëjnë Shtetet Anëtare, në përputhje me kriteret e parashtuara



në paragrafin 3, nënparagrafi i dytë dhe paragrafin 5, nënparagrafi i dytë”.³⁷

Në hapin final, ekzistojnë edhe dy procedura tjera të cilat e përmbyllin komplet ciklin, pra “Presidenti, Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit dhe anëtarët e tjerë të Komisionit i nënshtrohen si organ votë-pëlqimit nga Parlamenti Evropian. Pasi merret ky votë-pëlqim, Komisioni emërohet me shumicë të cilësuar nga Këshilli Evropian”.³⁸

Obligim me rëndësi në kuadrin e përgjegjësive institucionale është edhe llogaridhënia. Në këtë drejtim, llogaridhënia konsiderohet si element parësor në ofrimin e të dhënave për veprimet që Komisioni ka ndërmarrë gjatë mbajtjes s. Së këndejmi, neni 17 paragrafi 8 i Traktatit të Lisbonës (TBE) definojnë se “Komisioni si organ jep llogari përpara Parlamentit Evropian. Në përputhje me nenin 234 të

Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Evropian, Parlamenti Evropian mund të votojë një mocion mosbesimi ndaj Komisionit. Nëse mocioni miratohet, anëtarët e Komisionit japin dorëheqjen si organ dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit jep dorëheqjen nga detyrat që kryen në Komision³⁹. Si përfundim, Komisioni Evropian njihet për fuqinë ekzekutive që ka në raport me institucionet e tjera të BE-së dhe mban mbi supet e tij 4 përgjegjësi jetike për funksionimin e Bashkimit Evropian, si: propozimin e ligjeve të reja Parlamentit dhe Këshillit të BE-së, menaxhimin dhe zbatimin e politikave dhe buxhetit të BE-së, zbatimin e ligjit evropian në bashkëveprim me Gjykatën e Drejtësisë, përfaqësimin e Bashkimit Evropian në arenën ndërkombëtare në mënyrë specifike në zhvillimin e negociatave ndërmjet BE-së dhe shteteve të tjera.

³⁵ Ministria e Integritimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty, fq.28;

³⁶ Ministria e Integritimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty, fq.29;

³⁷ Ministria e Integritimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty, fq.29;

³⁸ Ministria e Integritimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty, fq.29;

³⁹ Ministria e Integritimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty, fq.29;



Selia e Gjykatës ndodhet në Luksemburg

gjykatat e specializuara. Ajo garanton respektimin e ligjit në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve”.⁴⁰

Në çështjen e përbërjes së Gjykatës së Drejtësisë, emërimin e gjyqtarëve dhe mandatin e tyre, neni 19 paragrafi 2 përcakton se “Gjykata e Drejtësisë përbëhet nga një gjyqtar nga secili Shtet Anëtar. Ajo mbështetet nga Avokatët e Përgjithshëm. Gjykata e Përgjithshme përfshin të paktën një gjyqtar për çdo Shtet Anëtar. Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjyqtarët e Gjykatës së Përgjithshme zgjidhen mes personave për pavarësinë e të cilëve nuk ka dyshime dhe që përmbushin kushtet e vendosura në nenet 253 dhe 254 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Ata emërohen për gjashtë vjet, me pëlqimin e përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare. Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm, të cilëve u ka mbaruar mandati, mund të riemërohen”.⁴¹

GJYKATA E DREJTËSISË E BASHKIMIT EVROPIAN

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian si institucion i BE-së është themeluar në vitin 1952, vit i cili karakterizon edhe hyrjen në fuqi të Traktatit Evropian për Thëngjill dhe Çelik. Roli i Gjykatës kryekëput ka të bëjë me sigurimin e legjislacionit dhe zbatimin e tij në mënyrë uniforme tek të gjitha shtetet anëtare pa bërë ndonjë dallim në interpretim. Njëkohësisht Gjykata merret edhe me sigurimin e interpretimit të Gjykatave vendore, nëse këto të fundit devijojnë në interpretimin e tyre, si dhe bënë

zgjidhjen e kontesteve të ndryshme ligjore ndërmjet shteteve anëtare, shteteve anëtare dhe BE-së, institucioneve të BE-së, bizneseve dhe qytetarëve të Bashkimit Evropian.

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian bazën ligjore e ka në nenin 19 të Traktatit të Lisbonës (TBE), në nenet 251-281 (TFBE) dhe neni 136 Euratom. Po qe se i referohemi nenit 19, paragrafi 1 të Traktatit të Lisbonës (TBE), Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian në gjirin e tij “përfshin Gjykatën e Drejtësisë, Gjykatën e Përgjithshme dhe

Andaj, shikuar në total, Gjykata e Drejtësisë përbëhet nga 28 gjyqtar, pra secili gjyqtar përfaqëson shtetin prej nga vjen, ndërkaq numri i Avokatëve të Përgjithshëm të cilët mbështesin Gjykatën e Drejtësisë janë gjithsejtë 8. Avokatët e Përgjithshëm duhet të jenë njerëz tejet kompetent të cilët më parë kanë ushtruar pozitën e gjyqtarit ose të avokatit në shtetet kombëtare. Gjithashtu, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian kryen një mori detyrash me qëllim të funksionimit dhe sigurimit të ligjshmërisë në BE.

⁴⁰ Ministria e Integrimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty, fq.29;

⁴¹ Ministria e Integrimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, fq.30;



Duke u bazuar në nenin 19 paragrafi 3 të Traktatit të Lisbonës (TBE), Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian në përputhje me Traktatet⁴²:

a) vendos për çështjet e ngritura nga një Shtet Anëtar, një institucion ose një person fizik apo juridik.

b) jep vendime paragykimore, me kërkesë të gjykatave të Shteteve Anëtare, për interpretimin e së drejtës së Bashkimit ose vlefshmërinë e akteve të miratuara nga institucionet;

c) vendos në çështje të tjera të parashikuara nga Traktatet.

Pra, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian si gjykata më e lartë e BE-së, për qëllim ka sigurimin e legjislacionit të BE-së, zgjidhjen e problemeve të ndryshme të cilat mund të shkaktohen nga palët dhe garantimin për funksionimin e rendit publik në BE.

Banka Qendrore Evropiane



Banka Qendrore Evropiane është themeluar në vitin 1998. Është institucion i Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, pjesë e së cilës janë të gjitha shtetet anëtare. “Ajo formon bashkë me Bankat Qendrore Kombëtare (BQK-të) të vendeve të BE-së, Sistemin Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ). Ajo është në kuadrin e BE-së një institucion sui generis dhe është një institucion supranacional me personalitet juridik⁴³. Selia e Bankës

ndodhet në Frankfurt. Banka Qendrore Evropiane bazën ligjore e ka në nenet 3 dhe 13 të Traktatit të Lisbonës (TBE), ndërkaq dispozitat kryesore janë përfshirë në nenet 3 (1) (c), 119, 123, 127-134, 138-144, 219, 282-284, të Traktatit të Lisbonës (TFBE) dhe një sërë protokollesh ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Banka Qendrore Evropiane menaxhon me monedhën euro me qëllim që “të siguroj stabilitetin e çmimit për më shumë

se dy të tretat e qytetarëve të BE-së të cilët e përdorin euron”⁴⁴. Pra, Banka në vazhdimësi monitoron lëvizjet ekonomike brenda BE-së dhe në bazë të nevojave që shfaqen vendos “standarde të kamatës të bazuar në analizën e zhvillimeve ekonomike dhe monetare. I rrit kamatat nëse dëshiron të frenojë inflacionin, dhe i ul ato nëse mendon se rreziku i inflacionit është i kufizuar”⁴⁵. Kjo lejon të nënkuptoj se Banka Qendrore Evropiane është

⁴² Ministria e Integrimit Evropian “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty;

⁴³ Prof.Dr.Blerim Reka, Prof.Dr.Otmar Holl, Prof.Dr. Ylber Sela, “Institucionet dhe Politikat e Unionit Evropian”, Botues Forumi për Shoqëri, Shkencë dhe Kulturë “Universitas” Tetovë 2010, fq 37;

⁴⁴ Komisioni Evropian “Si funksionon Bashkimi Evropian”, Udhërrëfyesi juaj për Institucionet e BE-së, Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim Publikimet, B-1049 Bruksel, fq 36;

⁴⁵ Komisioni Evropian “Si funksionon Bashkimi Evropian”, Udhërrëfyesi juaj për Institucionet e BE-së, Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim Publikimet, B-1049 Bruksel, po aty;



ruajtësi i fuqisë blerëse të euros. Banka Qendrore Evropiane është e organizuar në tre grupime kryesore të cilat i mundësojnë funksionimin dhe ofrimin e stabilitetit për eurozonën. Këto grupime janë si në vijim⁴⁶:

1 Këshilli i Përgjithshëm i Sistemit Evropian të Bankave Qendrore – ky këshill përbëhet nga guvernatorët e 28 bankave qendrore kombëtare e bashku me Presidentin BQE dhe nën presidentin;

2 Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore Evropiane përbëhet nga Kryetari, nënkryetari dhe katër anëtarë të tjerë - të gjithë të emëruar nga Këshilli i Evropës, duke vepruar me shumicë të cilësuar, me mandat për 8 (tetë) vite. Bordi Ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e politikës monetare, banka ditë për ditë ndërmerr veprime dhe përgatit mbledhjet e Këshillit drejtues, si



dhe ushtrimin e kompetencave të caktuara e deleguar nga Këshilli Drejtues;

3 Këshilli Drejtues i Bankës Qendrore Evropiane përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarët e Bordit Ekzekutiv BQE dhe guvernatorët e bankave qendrore kombëtare të 17 vendeve të eurozonës- së bashku ata formojnë Euro-sistemin. Këshilli Drejtues është organi kryesor vendimmarrës i Bankës Qendrore Evropiane dhe

mblidhet dy herë në muaj. Si rregull, në mbledhjen e parë të çdo muaji, Këshilli Drejtues vlerëson zhvillimet ekonomike e monetare dhe merr vendimet e tij mujore të politikës monetare. Në mbledhjen e tij të dytë, Këshilli kryesisht diskuton çështjet në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të Bankës Qendrore Evropiane.

Sa i përket çështjes së zonës euro, duhet theksuar se jo të gjitha shtetet anëtare të BE-së bëjnë pjesë në zonën e euros. Ky fakt vije për shkak se një pjesë e shteteve anëtare ende nuk janë të gatshme t’i bashkëngjiten zonës euro për arsye se ekonomitë e tyre ende janë në përgatitje dhe konsolidim e sipër për tu fuqizuar. Ndërkaq, ekziston edhe një pjesë e shteteve anëtare të cilat përkundër zhvillimit ekonomik dëshirojnë të mbesin opozitë. Më poshtë do të pasqyrojmë figuracionin lidhur me shtetet anëtare të cilat përdorin dhe nuk e përdorin euron. Shikuar në këndvështrimin e përgjithshëm, 18 shtete anëtare e përdorin euron (€), ndërkaq 10 shtete nuk e përdorin euron (€).

18 SHTETET ANËTARE TË BASHKIMIT EVROPIAN TË CILAT PËRDORIN EURON

AT:	Austria
ES:	Spain
MT:	Malta
BE:	Belgjika
FI:	Finland
NL:	Holanda
CY:	Qipro
FR:	Franca
PT:	Portugalia
DE:	Gjermania
IE:	Irlanda
SI:	Slllovenia
EE:	Estonia
IT:	Italia
SK:	Slllovakia
EL:	Greqia
LU:	Luksemburgu
LV:	Latvia

10 SHTETET ANËTARE TË BASHKIMIT EVROPIAN TË CILAT NUK E PËRDORIN EURON

BG:	Bullgaria
CZ:	Republika Çeke
DK:	Danimarka
HU:	Hungaria
LT:	Lituania
HR:	Kroacia
PL:	Polonia
RO:	Rumania
SE:	Suedia
UK:	Britania e Madhe

⁴⁶ The European Union explained “ How the European Union Works”. European Commission, Directorate-General Communication Publications, 1049 Brussels, Belgium, fq. 27;

GJYKATA E AUDITUESVE

Gjykata e Audituesve është themeluar në vitin 1975 dhe selia e tij ndodhet në Luksemburg. Gjykata e Audituesve është institucion i pavarur i Bashkimit Evropian dhe jo i ndikuar politikisht. Ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur nga institucionet dhe qeveritë e tjera të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Gjykata e Audituesve bazën ligjore e ka në nenin 285-287 të Traktatit të Lisbonës (TFBE).

Roli kryesor i Gjykatës së Audituesve është të kontrollojë fondet e Bashkimit Evropian se si janë mbledhur dhe si shpenzohen, si dhe të ndihmojë dhe të përmirësojë menaxhimin financiar të Bashkimit Evropian. Në kuadrin e tij janë të përfshirë njerëz kredibil dhe profesionist të përfaqësuar nga shtetet anëtare të BE-së. Po ashtu, Gjykata në fund të çdo viti kalendrik publikon raportin vjetor mbi shpenzimet financiare, raport i cili i prezantohet Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së.



Po qe se janë dhënë rekomandime në raport nga ana e Gjykatës së Komisioni nuk ka menaxhuar mirë me buxhetin, atëherë Parlamenti Evropian nxjerrë vendim lidhur me këtë çështje me qëllim që buxheti për vitin që vjen të menaxhohet më mirë nga ana e Komisionit. Gjykata e Audituesve është e organizuar mirë dhe ka të definuar çështjen e përfaqësimit dhe të zgjedhjes së anëtarëve dhe presidentit të tij, ku në këtë drejtim është precizuar se “Çdo shtet anëtar propozon një përfaqësues për Gjykatën e Audituesve i cili është i pavarur dhe i përshtatshëm

nga ana profesionale dhe që zgjidhet nga Këshilli i Ministrave pas konsultimit me PE-në për një periudhë 6 vjeçare. Në krye të Gjykatës qëndron presidenti, i cili zgjedhet nga radhët e anëtarëve për 3 vjet (me të drejtë rizgjedhje). Anëtarët mund të formojnë dhoma për raporte apo gjykime të caktuara. Zyrтари më i Lartë i Gjykatës është Sekretari i Përgjithshëm, i caktuar nga Gjykata dhe i ngarkuar me detyra administrative⁴⁷.

Në vështrimin e përgjithshëm, Gjykata e Audituesve konsiderohet si institucion i cili monitoron dhe filtron në mënyrë të detajuar çdo shpenzim që hynë dhe që del nga Bashkimi Evropian. Roli i Gjykatës është i pa zëvendësueshëm në kontrollin e parasë publike dhe qëllim final i tij është të sjellë frymë të shëndosh në fuqizimin e BE-së për sa i përket menaxhimit të mjeteve financiare.



Procedura legjislativë në Bashkimin Evropian

PROCEDURA LEGJISLATIVE NË BASHKIMIN EVROPIAN DHE ROLI I INSTITUCIONEVE TË BE-së NË PROCESIN E ZGJERIMIT

Përpara se të shohim procedurën e rregullt legjislativë, patjetër se është e domosdoshme të dimë se BE ka një legjislacion të gjerë i cili miratohet nga institucionet e tij dhe është i njohur me emrin Acquis Communautaire, pra Acquis përfshin gjithë legjislacionin e BE-së. Në burimet e së drejtës së BE-së janë të njohura këto tipe kryesore të burimeve formale si: burimet

primare të së drejtës të cilat përfshijnë të gjitha Traktatet e BE-së dhe burimet sekondare të cilat përfshijnë rregulloret, direktivat, vendimet, plus rekomandimet dhe opinionet të cilat nuk kanë fuqi detyruese. Piramida institucionale e cila është e ndërthurur dhe funksionon në çështjen e vendimmarrjes në hierarkinë e BE-së përfshin tre institucionet kryesore: Parlament

⁴⁷ Prof.Dr.Blerim Reka, Prof.Dr.Otmar Holl, Prof.Dr. Ylber Sela, “Institucionet dhe Politikat e Unionit Evropian”, Botues Forumi për Shoqëri, Shkencë dhe Kulturë “ Universitas” Tetovë 2010, fq 35;



Evropian, Këshilli i BE-së dhe Komision Evropian. Është e njohur që Komisioni Evropian propozon ligje të reja bazuar në rrethanat dhe nevojat që shfaqen, mirëpo çdo propozim i ri i cili vjen, bazën ligjore duhet ta ketë në Traktate, ndërkaq Parlamenti Evropian së bashku me Këshillin e BE-së i miratojnë ato, kurse në hapin final i mbetet Komisionit dhe shteteve anëtare t’i zbatojnë. Në këtë kontekst, për të miratuar një akt juridik domosdo ekziston disa procedura të cilat duhet ndjekur.

Në këtë drejtim, procedurat e rregullta legjislative janë tri:

1

Bashkë-vendimi

Procedurë që përdoret më së shumti në vendim-marrje në BE. Në procedurën e bashkë-vendimit, Parlamenti ndan fuqinë legjislative në mënyrë të barabartë me Këshillin. Nëse Këshilli dhe Parlamenti nuk mund të pajtohen për ndonjë pjesë të caktuar të legjislacionit, atëherë nuk do të ketë ligj të ri. Procedura përcakton dy ‘lexime’ të një pasnjëshme në secilin institucion. Nëse është arritur marrëveshja në këto lexime, ligji mund të kalohet. Nëse jo, i njëjti do të vihet para komitetit të pajtimit, i përbërë nga numri i barabartë i përfaqësuesve të Këshillit dhe Parlamentit. Pasi që ky komitet të ketë arritur një marrëveshje, teksti i pajtuar i dërgohet prapë Parlamentit dhe Këshillit në mënyrë që ata ta miratojnë

përfundimisht ligjin. Procedura e pajtimit po bëhet gjithnjë e më e rrallë. Shumica e ligjeve të kaluara në procedurën e bashkë-vendimit, në fakt, ose miratohen në leximin e parë ose në të dytin si rezultat i bashkëpunimit të mirë në mes të tri institucioneve;

2

Konsultimi

Procedura e konsultimit përdoret në fushat si bujqësi, tatim dhe konkurrencë. Bazuar në propozimin nga Komisioni, Këshilli konsulton Parlamentin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve. Në procedurën e konsultimit, Parlamenti mund ta: aprovojë propozimin e Komisionit, refuzojë atë ose kërkojë amendamente shtesë. Nëse Parlamenti kërkon amendamente shtesë, Komisioni do t’i marrë parasysh të gjitha ndërrimet që i sugjeron Parlamenti. Nëse pranon ndonjë nga këto sugjerime, do t’i dërgojë Këshillit një propozim të ndryshuar. Vendimi përfundimisht mbetet me Këshillin, i cili ose e miraton propozimin e amendamentuar apo e ndryshon atë më tej. Në këtë procedurë, sikur edhe në tjerat, nëse Këshilli e ndryshon një propozim të Komisionit duhet ta bëjë një gjë të tillë në mënyrë unanime;

3

Pëlqimi

Procedura e pëlqimit do të thotë se Këshilli duhet të sigurojë



pëlqimin e Parlamentit Evropian para se të merren vendime të caktuara që kanë rëndësi të madhe.

Kjo procedurë është e njëjtë si në rastin e konsultimit, përveç që Parlamenti nuk mund të ndryshojë propozimin: ose duhet ta pranojë ose ta refuzojë atë. Pranimi (“pëlqimi”) kërkon shumicë absolute në votim. Procedura e pëlqimit më së shpeshti përdoret për marrëveshjet me vendet tjera, përfshirë marrëveshjet që parashohin anëtarësimin e vendeve të reja në BE.⁴⁸

Pra, nga trajtimi i mësipërm kuptuam në mënyrë të detajuar se si është e rregulluar procedura legjislative. Për të parë për së afërmi se si shkon rrjedha e procedurës së rregullt legjislative, këtë më së miri e argumentojnë dy grafikonet e mëposhtme të cilat janë të ndërlidhura njëra me tjetrën.

⁴⁸ Komisioni Evropian: “Si funksionon Bashkimi Evropian”, Udhërrëfyese juaj për Institucionet e BE-së, , Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim Publikimet, B-1049 Bruksel, fq 6,7,8;






Fig. 6. Procedura e rregullt legislative



Roli i institucioneve të BE-së në procesin e zgjerimit

Institucionet e Bashkimit Evropian kanë rol mjaftë domethënës në procesin e zgjerimit. Shtetet kombëtare të cilat ndodhen brenda hartës së Evropës dhe të cilat dëshirojnë dhe kanë aspirata për tu bashkuar familjes së madhe evropiane, patjetër se veprimet e tyre duhet t'i kalojnë nëpërmjet 4 institucioneve të BE-së, në këtë rast Parlamentit Evropian, Këshillit Evropian, Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Komisionit Evropian.

Parlamenti Evropian në procesin e zgjerimit përkufizohet me disa kompetenca kyçe të cilat e determinojnë procesin e anëtarësimit të shtetit aplikant duke u nisur nga hapja e negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjeve të Asociimit e deri tek akti final i anëtarësimit të shtetit asociuar në BE, çështjet financiare ku ndërlihet përgatitja dhe miratimi i buxhetit, miratimin e rezolutave dhe konkluzioneve në procesin e zgjerimit etj. Mos të harrojmë se përbrenda Parlamentit Evropian ekziston Komiteti i Punëve të Jashtme i cili përgjatë gjithë kohës merret me procesin e zgjerimit duke bërë

koordinimin e aktiviteteve, bashkërendimin e qëndrimeve ndërmjet Komiteteve Speciale dhe Komiteteve të Përbashkëta të Parlamentit Evropian.

Roli i **Këshillit Evropian** në kontekstin e procesit të zgjerimit, kryekëput ndërlihet me mbajtjen e mbledhjeve të mëdha të cilat i organizon në një nga qytetet e bukura dhe historike të Evropës dhe në të cilat marrin pjesë krerët e shteteve anëtare të BE-së. Agjendat të cilat përgatiten nga Këshilli Evropian i japin orientim drejtimit politik të Evropës, ku veçanërisht Këshilli Evropian është i njohur për marrjen e vendimeve njëzëri për fillimin e negociatave për shtetin aplikant. Organi kryesor vendimmarrës dhe mjaftë thelbësor që merret me procesin e zgjerimit është **Këshilli i BE-së**. Procesi i anëtarësimit të një shteti (vendi) kalon në të gjitha fazat e saj përmes Këshillit të BE-së i cili merr vendime për të ndaluar apo dërguar para procesin e anëtarësimit të vendit aplikues. Tejet e rëndësishme është se cili nga shtetet anëtare të BE-së e kryeson presidencën e

Këshillit, për shkak se aty vendosen prioritetet lidhur me dërgimin para të procesit të anëtarësimit të një shteti.

Komisioni Evropian është i njohur si përgjegjës kryesor për procesin e ekzaminimit dhe hartimit të pozicio-

neve negociuese për vendet anëtare. Këshilli e pajis me mandat negociimi Komisionin Evropian për të zhvilluar negociatave me shtetin aplikant. Brenda Komisionit Evropian, është i njohur Komisioneri për Zgjerim i cili direkt merret me procesin e para-anëtarësimit të një shteti, zhvillimin e negociatave dhe marrëveshjeve me shtetet të cilat janë vende kandidat dhe potencial kandidat. Pra, para se të merren vendimet nga institucionet tjera të BE-së, Komisioni Evropian përgatit raporte apo opinione përpara se të filloj procesi i anëtarësimit të një shteti dhe negociimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Gjithashtu, Komisioni Evropian përgatit raporte vjetore të njohura si raporte të progresit të cilat pasqyrojnë sfidat dhe të arriturat e vendit aspirues. Është interesante se Komisioni Evropian komunikimin me shtetin aspirues e zhvillon nëpërmjet komunikatave dhe strategjive me qëllim të orientimit dhe ofrimit të mbështetjes drejt hapave që duhet ndjekur dhe që duhet ndërmarrë.

Si përfundim, mund të themi se vetë natyra e BE-së është komplekse dhe përgjegjësitë që institucionet i posedojnë kanë një korrelacion të gjerë dhe të vazhdueshëm në raport me njëra tjetrën. Ky fakt e bënë edhe më të qartë se procesi i anëtarësimit të një vendi në Bashkimin Evropian nuk është edhe aq i lehtë, pra, kërkon vendosmëri, punë, angazhim dhe zbatim të kriterëve në mënyrë që të përafrohet dhe të jetë konkurrentë me shtetet e tjera anëtare për sa i përket zhvillimit dhe arritjeve të përgjithshme.





PROCESI I ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË BE

Të jesh shtet anëtar me të drejta të plota i BE-së do të thotë të kesh arritur plotësimin e standardeve evropiane përfshirë “vlerat e përbashkëta evropiane, Kriteret e Kopenhagës 1993(standardet politike, ekonomike dhe ligjore) dhe Kriteret e Madridit të vitit 1995 (standardet administrative)”⁴⁹. E drejta për të aplikuar për anëtarësim në BE u epet vetëm shteteve të cilat përcaktohen gjeografikisht dhe ndodhen brenda Evropës, si dhe nëse respektojnë parimet më fundamentale të lirisë, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.

Këtë më së miri e konkretizon dhe e përcakton neni 2 i Traktatit të Lisbonës (TBE) cili thotë se “Bashkimi ka në themel vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut,

lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Këto vlera janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare në një shoqëri në të cilën mbisundon pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis grave dhe burrave”⁵⁰. Ndërsa, neni 49 i Traktatit të Lisbonës(TBE) përcakton procedurën e aplikimit se si rrjedh procesi në fjalë, ku “Çdo Shtet Evropian, i cili respekton vlerat e përmendura në nenin 2 dhe është i angazhuar për nxitjen e tyre, mund të kërkojë të bëhet anëtar i Bashkimit. Parlamenti Evropian dhe Parlamentet kombëtare njoftohen për këtë kërkesë. Shteti kërkues ia drejton kërkesën Këshillit, i cili vepron unanimisht, pasi konsultohet me Komisionin dhe pasi

merr pëlqimin e Parlamentit Evropian, i cili vepron me shumicën e deputetëve që e përbëjnë. Merren në konsideratë kushtet e pranueshmërisë të miratuara nga Këshilli Evropian”⁵¹. Ky fakt do të thotë që shteti aspirant duhet të posedoj një konglomerat vlerash universale me të cilat duhet të dëshmojë që ka një bazë të shëndosh për të parashtruar kërkesën për anëtarësim. Gjithsesi, procesi i anëtarësimit është jashtëzakonisht i vështirë dhe i gjatë, si dhe në vete ngërthen dy aspekte kryesore me të cilat shteti aspirues do të përballet e ato janë aspekti politik dhe teknik. Në këtë rrugëtim, shteti aspirues do të zhvillojë tre drejtime kryesore të procesit të integrimit të cilat paralelisht duhet të zhvillohen njëra me tjetrën, në një drejtim të vetëm. “Drejtimi i parë ka të bëjë me procesin e qasjes së shtetit në

⁴⁹ Blerim Reka: “Gjeopolitika dhe Teknika e Zgjerimit të BE-së”, botues ASPECT, Bruksel, fq.282.

⁵⁰ Ministria e Integrimit Evropian: “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty fq.20;

⁵¹ Ministria e Integrimit Evropian: “Versioni i Konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Evropian dhe Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian”, MIE, Tiranë, Republika e Shqipërisë, po aty fq.45;



“UDHËZUES PËR ROLIN E KOMUNAVE NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN TË KOSOVËS”



regjimin pa viza me BE-në përmes dy fazave: fazën e lehtësimit të vizave dhe atë të liberalizimit të vizave; Drejtimi i dytë ka të bëjë me qasjen në fondet e BE-së, përkatësisht të thithë mbështetjes financiare para anëtarësimit. Sikundër, dihet vetëm me anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian, shtetet anëtare mund t'i

shfrytëzojnë fondet e caktuara të mbështetjes. Në fillim ato ishin të nduarnduarshme dhe menaxhoheshin nga agjencitë e caktuara të BE-së. Nga viti 2007, Komisioni Evropian e inauguroi instrumentin e ri financiar para anëtarësimit IPA i cili i unifikon fondet evropiane madje edhe të shteteve anëtare, për arsye se i

kishin keqmenaxhuar ato. Drejtimi i tretë plotësimi i kriterëve për anëtarësim dhe i detyrimeve të MSA-së. Ky është procesi më i vështirë për shtetin aspirant sepse duhet përbushur në përpikëri prej një faze në fazë Kriteret e Kopenhagës/Madridit dhe gjithnjë duke iu përmbajtur edhe detyrimeve që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim Asociim me BE-në⁵².

Më tej, të njohura janë fazat përmes së cilave shteti aspirant duhet të kalojë, kështu duke përshkruar etapat e lëvizjes drejt anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian të përmbledhura në mënyrë kronologjike. Pra, “ del se anëtarësimit të plotë në BE i paraprinë periudha e para – anëtarësimit(apo, ajo asociuese). Duhet të arrihet konsensusi i 28 shteteve anëtare të BE-së për fillimin e negociatave për nënshkrimin e MSA-së me një shtet pretendues. Kjo nënkupton që, së pari, grupi i ekspertëve i caktuar nga Komisioni Evropian, pas hulumtimeve për atë vend dhe pas hartimit të studimit të fizibilitetit, t’i propozoj Komisionit mendimin për gatishmërinë e atij shteti për MSA. Komisioni këtë rekomandim ia përcjell Këshillit të Ministrave dhe vetëm pas pëlqimit të 28 shteteve anëtare, Komisioni nxjerr direktivë përkatëse për fillimin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Me këtë direktivë fillojnë negociatat për nënshkrimin e MSA-së e cila duhet të konkludohet me nënshkrimin e MSA-së dhe më pas ratifikimin e saj nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim, shtetit kandidat potencial, fillimisht i dorëzohet pyetësori që duhet ta plotësojë dhe në bazë të përgjigjeve të marra nga Këshilli Evropian vendos nëse atij shteti do t’i jepet statusi i kandidatit. Me

⁵² Blerim Reka: “Gjeopolitika dhe Teknika e Zgjerimit të BE-së”, botues ASPECT, Bruksel, fq.381-382.

fitimin e statusit të kandidatit, vendi i fillon negociatat për anëtarësim, kurse pastaj vazhdohet me mbështetjen financiare të kësaj faze nga ana e BE-së. Rëndom si masë e parë stimuluese politike është heqja e vizave për shtetasit që ndodhet në procedurën e anëtarësimit të plotë. Procesi i tillë i filluar vlerësohet veçmas për secilin shtet nga institucionet më të larta të BE-së (Këshilli, Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian) dhe rezultatet e këtij vlerësimi publikohen në raportet periodike të BE-së si raporte të progresit të Komisionit Evropian, ashtu edhe raporti vjetor i Parlamentit Evropian. Sa i përket Raportit vjetor të progresit të KE-së, Komisioni Evropian e jep vlerësimin e vet për reformat në atë shtet, të cilin ia prezanton Parlamenti Evropian, kurse Këshilli, në konkluzionet e veta, e jep vlerësimin përfundimtar vjetor për përparimin e një shteti që e aspiron anëtarësimin në BE. Pas shqyrtimit të vazhdueshëm të plotësimit të këtyre kushteve nga shteti kandidat dhe përmbylljes së negociatave për të gjithë kapitujt e *acquis*, vendoset për anëtarësimin e tij në BE. Vendimi për pranimin e një shteti në anëtarësi të BE-së është një akt solemn i shpalljes së anëtarëve të rinj të BE-së dhe ai pasohet me nënshkrimin e Marrëveshjes për anëtarësim. Marrëveshja e nënshkruar për hyrjen e një vendi në BE me statusin e anëtarit të plotfuqishëm duhet pastaj të ratifikohet nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe nga parlamenti kombëtar i shtetit përkatës⁵³. Mirëpo, duhet të kemi parasysh faktin se procesi i anëtarësimit të shteteve në Bashkimin Evropian nuk ka qenë i njëjtë për të gjitha shtetet për shkak të aspektit gjeopolitik dhe gjeostrategjik, si dhe zhvillimeve që kanë ndodhur në Evropë. Së këndejmi, po qe se i referohemi Ballkanit Perëndimor, dihet mirëfilli



se kjo pjesë e Evropës nga vitet 90-ta ka përjetuar konflikte dhe luftëra të cilat kanë shkaktuar dëme të mëdha njerëzore e materiale. Në këtë kontekst, BE duke e parë gjendjen e krijuar në Ballkanin Perëndimor dhe me qëllim që të stabilizoj këtë pjesë, ndërmori nismat e para serioze për të krijuar të ashtuquajturin Pakt të Stabilitetit. Ky pakt parashihte dhe synonte të bëjë zëvendësimin e ndërhyrjeve në rast të krizave me strategji afatgjate të parandalimit të konflikteve. Më pas, Pakti i Stabilitetit u zëvendësua me Procesin e Stabilizim Asociimit e cila u themelua në vitin 1999 për vendet e Ballkanit Perëndimor për të shërbyer si kornizë në procesin e anëtarësimit në BE, ndërsa në nëntor të vitit 2000 në Samitin e Zagrebit zyrtarisht filloi procesi i Stabilizim Asociimit i cili potencoi qartë se perspektiva Evropiane e vendeve të Ballkanit Perëndimor do të përcaktohet në bazë të progresit të tyre drejt një demokracie të qëndrueshme, sundimit të ligjit, ekonomisë së tregut dhe bashkëpunimit rajonal. Mirëpo, duhet potencuar se në këtë periudhë kohore, pra në vitin 1999, Kosova bazuar në Rezolutën 1244 ndodhej nën protektoratin ndërkombëtar të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (pra, misioni UNMIK i cili do të administronte Kosovën për një periudhë transitore), si dhe ishte në

hapat e parë të krijimit të institucioneve vendore (të njohura si Këshilli i Përkohshëm Administrativ(KPA) dhe më pas Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisëse të Kosovës IPVQ). Pas konsolidimit të institucioneve vendore, bashkësia ndërkombëtare (në pajtim me Qeverinë e Kosovës) me qëllim që mos ta lërë anash Kosovën në procesin e integrimit evropian, i vuri disa standarde Kosovës për t'i zbatuar dhe të cilat kishin për qëllim t'u mundësonin popullit të jetonte, vepronte, punonte, udhëtonte dhe përparonte në siguri të plotë. Këto standarde korrespondonin me hapjen e perspektivës së Kosovë drejtë integrimit evropian. Në këtë kontekst, standardet u publikuan më 10 dhjetor 2003 dhe përmbanin më shumë se 400 veprime, kurse më 31 mars 2004, IPVQ dhe UNMIK, paraqitën planin i cili përcaktonte veprimet të cilat do të ndërmerren për të përmbushur apo zbatuar këto standarde. Viti 2005 shënon nisjen drejt zbatimit të këtyre standardeve. Standardet prioritare të njohura si 8 standarde për Kosovën ishin: 1) Institucionet demokratike funksionale; 2) Sundimi i Ligjit; 3) Liria e Lëvizjes; 4) Kthimet e qëndrueshme dhe të drejtat e bashkësive dhe

⁵³ Blerim Reka: "Gjeopolitika dhe Teknika e Zgjerimit të BE-së", botues ASPECT, Bruksel, fq.387-388.



pjesëtarëve të tyre; 5)Ekonomia; 6) Të drejtat pronësore; 7)Dialogu; 8)Trupat e Mbrojtëse të Kosovës (TMK)⁵⁴. Po në të njëjtin vit 2003, në Samitin e Selanikut, Këshilli Evropian vetëm sa përforcoi konfirmimin se Ballkani Perëndimor ka të ardhmen e saj në BE. Nga këtu, Kosova vetëm shënoi përfshirjen e saj në kornizën e Procesit të Stabilizim Asociimit(PSA)⁵⁵, ku në vitin 2005 Komisioni Evropian miratoi komunikatën “ E ardhmja evropiane për Kosovën”. Lirisht mund të themi se u krijua një ndërlidhje e shkëlqyer e veprimeve të cilat korrespondojnë me standardet për Kosovën dhe përfshirjen e Kosovës në Mekanizmin Përcjellës të PSA-së. Ndërsa, vitet 2006-2008, Kosova karakterizohet me 2 Partneritete Evropiane të miratuara nga Këshilli, ndërkaq Qeveria e Kosovës miraton Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian në vitin 2008, plan i cili rishikohej çdo vit pas publikimit të Raportit të Progresit. Çfarë e bënë edhe më madhështor këtë proces është data 17 shkurt 2008, atëherë kur Kosova u shpall shtet i pavarur, sovran dhe demokratik. Një vit më vonë, 2009, Komisioni Evropian propozoi thellimin dhe forcimin e perspektivës Evropiane të Kosovës ku në komunikatën e publikuar “ Kosova-Përmbushja e Perspektivës së saj Evropiane” dha këto propozime: (1) Përmirësimi i dialogut politik dhe teknik në Procesin e Dialogut të Stabilizim Asociimit; (2) Dialogu i vizave me perspektivë të liberalizimit eventual

të vizave; (3) Zgjerimi i Masave Tregtare Autonome dhe marrëveshja e mundshme tregtare me Bashkimin Evropian; (4) Korniza e marrëveshjes me Kosovën mbi parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes së saj në programet e Komunitetit; (5) Aktivizimi i komponentit IPA për bashkëpunim ndër-kufitar (komponenti II)⁵⁶.

Komisioni Evropian në tetorin e vitit 2012 publikoi Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës, ku u konfirmua se “Kosova është krejt e gatshme për të filluar negociatat për një Marrëveshje të Stabilizim Asociimit⁵⁷ Por, përveç kriterëve të përcaktuara, strategjia e re e zgjerimit të BE-së parashihte që Kosova duhet të ketë marrëdhënie të mira ndër-fqinjësore, në mënyrë specifike me Serbinë, kështu duke zbatuar të gjitha marrëveshjet

e arritura në mes të Prishtinës dhe Beogradit me arsyetimin për të filluar negociatat për MSA-në. Në këtë drejtim, Komisioni Evropian propozoi direktivat negociuese për MSA-në, ngase Kosova ka përmbushur prioritetet afatshkurtra në fushën e sundimit të ligjit, administratës publike, mbrojtjes së minoriteteve dhe të tregtisë. Kurse, më 12 Dhjetor 2012, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së ka marr parasysht Studimin e Fizibilitetit për MSA në mes të BE-së dhe Kosovës dhe qëllimin e Komisionit për të propozuar direktivat negociuese për MSA-në, ngase Kosova kishte përmbushur prioritetet afatshkurtra, të cilat janë identifikuar në Studimin e Fizibilitetit. Në këtë kontekst, në muajin prill 2013, Komisioni Evropian publikoi raportin monitorues për zbatimin e kriterëve afatshkurtra dhe konfirmoj që Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret afatshkurtra për nisjen e negociatave për MSA. Duke marr për bazë raportin e prillit të Komisionit Evropian, me 28 qershor 2013, Samiti Evropian mori vendim për nisjen e negociatave për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Negociatat për MSA kanë filluar me 28 tetor 2013 me takimin e parë në nivel të Kryenegociatorëve. Negociatat kanë përfunduar në pranverën e vitit 2014. Për më tepër, Plani i Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në mënyrë konkrete shpjegon historikun e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe BE-së, si dhe datat kyçe historike që ndërlidhen me këtë proces. Këto data janë ilustruar në aneksin 1 të Udhëzuesit.



⁵⁴ Broshura: “ Standardet për Kosovën”, UNMIK/IPVQ, dhjetor 2003, fq. 5-13;

⁵⁵ Me qëllim që Kosova të mos ngelet prapa në procesin e integrimit evropian për shkak të mos definimit të statusit të saj, BE krijoi një formë apo emërtim të veçantë të Procesit të Stabilizim Asociimit për Kosovën i njohur si Mekanizmi Përcjellës i Procesit të Stabilizim Asociimit. Ndërkaq, me shpalljen e pavarësisë së Kosovës datë 17 shkurt 2008, ky emërtim u ndryshua në Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit.

⁵⁶ Ministria e Integrimit Evropian: “Plani i Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit 2014”, mars 2014, Prishtinë, fq.6;

⁵⁷ Po aty



E ARDHMJA E EVROPËS

Bashkimi Evropian ngjashëm sikurse vendet e tjera të botës është përballur me krizën globale. Kriza globale në mënyrë të drejtpërdrejtë ka ndikuar në ngadalësimin e ritmit, veçanërisht në reforma dhe procesin e zgjerimit të BE-së. Mirëpo, Bashkimi Evropian ka ndërmarrë hapa të shpejtë në hartimin e një strategjie për zgjerimin e qëndrueshëm të tij, strategji e cila parasheh një periudhë të gjatë prej 10 viteve.

Kjo strategji është hartuar në vitin 2010 dhe për qëllim ka nxitjen drejtë reformës dhe shtimin e masave për zgjerim më të qëndrueshëm dhe ekonomi më

stabile për të ardhmen. Strategjia Evropa 2020 përmban objektiva tejet ambicioze dhe largpamëse në fushat si punësim, inovacion, arsimim, përfshirje sociale dhe klimë/energji. Në këtë drejtim, Strategjia parasheh:

- 1** Sigurimi i një punësimi prej 75% për personat e moshës 20–64 vjeçare;
- 2** Investimi 3% nga BPV i BE-së për hulumtim dhe zhvillim;
- 3** Kufizimi i emetimeve të gazit serre deri për 20% ose edhe për 30% në krahasim me nivelet e vitit 1990, duke prodhuar 20% të nevojave për energji nga

energji e ripërtërishme dhe rritjen e efikasitetit të energjisë për 20%;

4 Ulja e shkallës së braktisjes së shkollimit deri në më pak se 10%, me të paktën 40% të personave të moshës 30–34 vjeçare me shkollim të lartë;

5 Sigurimi se 20 milionë njerëz më pak janë në rrezik nga varfëria ose përjashtimi social⁵⁸.


Pra, strategjia shihet si udhërrëfyes drejtë zhvillimit ekonomik, arsimit, ideve inovative, mirëqenies sociale dhe rritjes së numrit të të punësuarve në 75%. Po ashtu, ky fakt ka

⁵⁸ Komisioni Evropian, Kuptimi i Bashkimit Evropian: “Evropa 2020:Strategjia evropiane e zgjerimit”, Bruksel, dhjetor 2012, fq.3.



ndikim edhe në çështjen e procesit të zgjerimit të BE-së me shtete të reja. Kur jemi tek procesi i zgjerimit, duhet theksuar se pas valës së pestë të zgjerimit të BE-së në të cilin u anëtarësuan Bullgaria dhe Rumania (2007), vala e radhës së zgjerimit të BE-së u plotësua me Kroacinë me 1 korrik të 2013, kështu duke shtuar numrin e shteteve anëtare të BE-së në 28. Përveç kësaj, domosdo shtrohet nevoja e trajtimit të çështjes se si është duke u parë Bashkimi Evropian sot, sfidat të cilat janë shfaqur në opinion e gjerë lidhur me krijimin e Shteteve të Bashkuara të Evropës dhe forcës së sigurisë ngjashëm sikurse aleanca veri-atlantike NATO.

Zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtura në muajin maj të vitit 2014, për fitues nxorën



Partinë Popullore Evropiane me 29.43%. Krahu i kësaj partie proklamoi idenë e krijimit të federatës apo krijimit të Shteteve të Bashkuara të Evropës si diç tejet të nevojshme dhe në rrafshin institucional, po qe se analizojmë traktatet që nga fillimi e deri më sot, vërejmë se roli dhe kompetencat e Parlamentit Evropian janë fuqizuar nga traktati në traktat, kështu duke e bërë PE-në institucion të barasvlershëm me Këshillin e BE-së në procesin e vendimmarrjes. Këto elemente

vetëm sa e sigurojnë dhe përforcojnë qëndrimin drejt një statusi të ri të BE-së. Në anën tjetër mos të harrojmë se sfida mbetet siguria në BE. Bashkimi Evropian ende nuk e posedon një forcë ushtarake të integruar ashtu sikurse NATO, por në kuadrin e saj e posedon një trup kompakte të përbërë nga 1000 ushtarë të shteteve anëtare e paraparë për intervenime të shpejta në rast të paraqitjes së konflikteve të mundshme.

Fare në fund, mund të themi se Bashkimi Evropian është duke rrëshqitur drejt krijimit të Shteteve të Bashkuara të Evropës e përmes saj, drejt krijimit të një force ushtarake ekuivalent me NATO-n me qëllim të forcimit të identitetit dhe përballjes me situatat e padëshiruara globale.





PJESA E DYTË

(ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E KOMUNAVE NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN TË KOSOVËS)

Obligimet e Mapl-Së Dhe Komunave Që Dalin Nga Rregullorja Për Themelimin E Zyrave Komunale Për integritime Evropiane.

Rregullorja Nr. 08/2011 Për Organizimin dhe përgjithësitë e Zyrave Komunale për integrim Evropian përcakton funksionimin, detyrat, përgjegjësitë si dhe statusin e Zyrave Komunale për integrim Evropian në kuadër të Komunave. Zyrat Komunale për integrim Evropian themelohen në kuadër të çdo Komune dhe veprojnë nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës përkatëse.

Zyra komunale për integritime Evropiane është përgjegjëse për koordinimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me integrimin evropian në nivel komunal, dhe si të tilla sigurojnë kryerjen e të

gjitha obligimeve të Komunave përkatëse në kuadër të këtij procesi.

Zyra Komunale për integritime Evropiane

Zyra ka funksionet si vijon⁵⁹:

- Koordinon procesin e integritimit evropian;
- Koordinimin e procesit të zhvillimit të kornizës rregullative dhe të politikave të Komunës që ndërlidhen me procesin e integritimit evropian dhe që dalin nga dokumente strategjike, si ato nacionale ashtu edhe ato lokale, të këtij procesi, përfshirë pjesëmarrjen në caktimin e prioriteteve komunale në këtë aspekt dhe koordinimin e realizimit të obligimeve të
- Komunës që dalin nga marrëdhëniet Kosovë-BE;
- Pjesëmarrjen në caktimin e prioriteteve komunale dhe

zhvillimit të kornizës rregullative dhe të politikave nga ana e Drejtorive sektoriale, me qëllim të reflektimit të obligimeve përkatëse në lidhje me integrimin evropian në kuadër të secilit sektor;

- Monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit të këtyre dokumenteve strategjike dhe prioriteteve komunale të Kryetarit të Komunës dhe autoritetet qendrore, përmes Ministrisë
- Përgjegjëse për Qeverisje Lokale;
- Koordinimin e asistencës së BE-së dhe asistencës tjetër të jashtme;
- Koordinimin dhe pjesëmarrjen në zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe strategjive me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të Komunave për të kryer më sukses të gjitha reformat e

⁵⁹ Rregullore nr. 08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrave komunale për integrim evropian



nevojshme, përfshirë monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit të tyre;

- Ofrimin e mbështetjes të gjitha strukturave komunale në përmirësimin e konsultimeve dhe dialogun civil me shoqërinë civile lokale dhe palët e tjera të interesuara dhe publikun e gjerë në nivelin komunal.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për integrimin Evropian⁶⁰:

- I ofron mbështetje, këshilla dhe ekspertizë profesionale Kryetarit të Komunës dhe Drejtorëve komunalë në përcaktimin dhe vendosjen e prioritetëve të Komunës në fushën e integrimit evropian, duke marrë parasysh dhe me qëllim të kryerjes së obligimeve që dalin për Komunën nga të gjitha dokumentet strategjike nacionale për integrim evropian dhe marrëdhëniet Kosovë-BE;
- Koordinohet ngushtë me Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe Drejtorët e Drejtorive, si dhe me të gjitha strukturat e tjera vendimmarrëse komunale, në zhvillimin dhe avancimin e kornizës rregullative dhe të politikave të Komunës.
- Koordinohet ngushtë me Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe Drejtorët e Drejtorive, si dhe me të gjitha strukturat e tjera vendimmarrëse

komunale, në hartimin e planit vjetor të Komunës, me qëllim të reflektimit të prioritetëve dhe objektivave që përmbajnë dokumentet strategjike komunale, duke marrë parasysh dhe me qëllim të kryerjes së obligimeve që dalin për Komunën nga të gjitha dokumentet strategjike nacionale për integrim evropian dhe marrëdhëniet Kosovë-BE;


- Koordinohet dhe konsultohet ngushtë me Ministrinë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale dhe me Ministrinë e Integrimit Evropian, me qëllim të sigurimit të harmonizimit të prioritetëve dhe politikave të Komunës me kornizën nacionale legjislativë dhe të politikave për vetëqeverisje lokale dhe për integrim evropian, si dhe me qëllim të reflektimit të dokumenteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vetëqeverisje lokale dhe integrim evropian. Koordinohet dhe konsultohet ngushtë me strukturat udhëheqëse komunale (Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Drejtorët e Drejtorive dhe strukturat e tjera relevante komunale) dhe me strukturat qendrore (Ministrinë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale dhe atë të Integrimit Evropian) për të siguruar pajtueshmërinë e kornizës rregullative dhe të politikave komunale me standardet e BE-së.
- Merr pjesë në përcaktimin dhe planifikimin e aktiviteteve të Komunës në kuadër të

dokumenteve strategjike nacionale për integrim evropian, në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale dhe Ministrinë e Integritimeve Evropiane.

- Bën monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit të prioritetëve dhe dokumenteve strategjike të Komunës, si dhe të aktiviteteve relevante në kuadër të dokumenteve strategjike nacionale për integrim evropian dhe obligimeve të Komunës që dalin nga marrëdhëniet Kosovë-BE.
- Koordinohet dhe bashkëpunon ngushtë me Ministrinë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale dhe Ministrinë e Integrimit Evropian, për të siguruar reflektimin e sfidave, nevojave, arritjeve të Komunës në punën e rregullt të Strukturave Koordinuese Ndër-Institucionale për integrim Evropian.
- Koordinon, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale dhe atë të Integrimit Evropian, programimin dhe implementimin e asistencës së BE-së dhe të asistencës nga burime të tjera të jashtme (bilaterale dhe multilaterale), në kuadër të Komunës.
- Ofron mbështetje dhe këshilla shërbimeve juridike të Komunës dhe Komisioneve të Kuvendit Komunal me qëllim të reflektimit të Acquis-së dhe politikave përkatëse të BE-së në

⁶⁰ Rregullore nr. 08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrave komunale për integrim evropian.

⁶¹ Neni 6, pika 5 3 rregullores Nr. 08/2011 për Themelimin e Zyrave Komunale për integrim Evropian.



zhvillimin e kornizës rregullative të Komunës, si dhe kujdeset që reforma e kornizës rregullative komunale të reflektohet në punën e ekzekutivit dhe legjislativit të Komunës.

- Koordinohet dhe bashkepunon me Zyrën e Personelit në Komunë për ngritjen e kapaciteteve të stafit në çështjet që lidhen me integrimin evropian.
- Koordinohet dhe bashkepunon ngushtë me Zyrën për Komunikim dhe informim me

Publikun në Komunë për çështjet e komunikimit dhe informimit që kanë të bëjnë me integrimin evropian.

- Ndërmerr të gjitha veprimet tjera të kërkuara nga Kryetari i Komunës që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës.

Obligimet e MAPL-së që dalin nga rregullorja për themelimin e zyrave komunale për integrimin Evropian
Në bazë të Rregullores Nr. 08/2011, Kryetari i Komunës do

të konsultohet me Ministrinë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale dhe atë të integritimit Evropian, me qëllim që të sigurohet që e secilës Zyrëpër integrimin Evropian në mënyrë të reflektojnë pesë shtyllat kyçe⁶¹:

- kornizën e politikave të integritimit evropian;
- asistencën e BE-së;
- koordinimin e donatorëve të tjerë bilateralë dhe multilateralë;
- ngritjen e kapaciteteve; dhe
- komunikimin e informimit publik.



Detyrat e Departamentit për integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në kuadër të MAPL-së

Rregullorja e organizimit të brendshëm të MAPL-së⁶² themelon Departamentin për integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP). Përgjegjësitë dhe detyrat e departamentit janë rregulluar me rregulloren qeveritare⁶³. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për integrim Evropian dhe koordinim të Politikave në kuadër të MAPL-së janë listuar si vijon:

- Ofron mbështetje në bashkërendimin e aktiviteteve për procesin e integritimit evropian;
- Monitoron dhe raporton për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian;
- Ofron mbështetje në harmonizimin e legjislacionit të ministrisë me acquis communautaire;
- Koordinon aktivitetet e Ministrisë

për mbështetjen financiare të instrumentit të paraantarësimit (IPA) dhe fondet tjera të bashkimit Evropian;

- Kontribuon në shkëmbimin e informatave në funksion të procesit të integritimit Evropian, për fushë-veprimtarinë e ministrisë.

Në kuadër të Departamentit për integrim evropian dhe koordinim të Politikave janë dy divizione: Divizioni për integrim Evropian dhe Divizioni për Koordinim të Politikave.

Divizioni përgjegjës për procesin e integritimeve Evropiane ka detyrat si vijon:

- Ofron mbështetje në bashkërendimin e aktiviteteve për procesin e integritimit evropian;
- Siguron informacionet për hartimin e Planit të Veprimit për Partneritetin Evropian (PVPE), PVNMSA dhe siguron harmonizimin e tij me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe dokumentet tjera strategjike;
- Monitoron zbatimin e PVPE-së dhe

PVMSA dhe raporton tek institucionet relevante;

- Koordinon asistencën e IPA-së, dhe asistencën e jashtme bilaterale dhe multilaterale për aktivitetet e ministrisë, dhe siguron që ajo ndërlihet me prioritetet e ministrisë;
- Ofron mbështetje për strukturat organizative të ministrisë gjatë përgatitjes dhe menaxhimit të projekteve;
- Ofron mbështetje strukturës organizative përgjegjëse për çështje ligjore pranë ministrisë sa i përket përfshirjes së politikave të BE-së në legjislacionin vendor gjatë harmonizimit me acquis communautaire dhe kujdeset që legjislacioni i paraparë me PVPE dhe PVNMSA integrohet në Programin Legjislativ të Qeverisë;
- Ofron mbështetje në organizimin dhe në mbarëvajtjen e takimeve të rregullta për procesin e Stabilizim Asociimit, për çështjet që ndërlihen me fushëveprimtarinë e ministrisë.



⁶² Rregullore nr. 03/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të ministrisë së administrimit të pushtetit lokal

⁶³ Për Departamentet Për integrim Evropian Dhe Koordinim Të Politikave Në Kuadër Të Ministrive



OBLIGIMET E MAPL-së DHE KOMUNAVE NË PROCESIN E RI-INTEGRIMIT TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR

MAPL që nga viti 2007 ka marrë pjesë aktive në procesin e hartimit të strategjive dhe implementimin e planit të veprimit në kuadër të procesit të ri-integrimit të personave të riatdhesuar është i përcaktuar me edhe “Strategjinë e Rishikuar për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar 2010” dhe së fundi me “Rregulloren QRK nr.20/2013 për ri-integrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të ri-integrimit 2013”.

Obligimet e MAPL-së bazuar në STRATEGJINË e RISHIKUAR PËR RI-INTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR

Ministritë për gjegjëse në kuadër të procesit të ri-integrimit dhe ri-atdhesimit janë:

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Arsimit, Shkencës

dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Në këtë kuadër MAPL ka pasur rolin e koordinuesit edhe në raport me Komunitat. Bazuar në këtë rregullore MAPL ofron bashkëpunim të ngushtë në hartimin e politikave të ri-integrimit së bashku me ministritë e linjës si: MPB, MPMS, MMPH, MSH, MASHT, MF, MTI, MZHE, MeD, MKK dhe MBPZHR. Pra, të gjitha ministritë, duke përfshirë edhe MAPL-në, duhet të përcaktojnë objektivat për zbatimin e Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe zhvillimin e ri-integrimit si pjesë të planit operativ dhe financiar të saj⁶⁴.

Obligimet e Komunave në procesin e ri-integrimit dhe ri-atdhesimit

Komunitat kanë obligimet e tyre sa i përket sigurimit të banimit, kujdesin

për të ofruar shërbimet pulike komunale, edukimit të fëmijëve dhe kurset e gjuhëve;

Komuna përkatëse është përgjegjëse për sigurimin e banimit bonusit të banimit të përshtatshëm për personat e riatdhesuar pas periudhës së ri-integrimit prej dymbëdhjetë (12) muajsh. Komunitat, po ashtu sigurojnë shërbimet themelore komunale siç janë: këshillimi, regjistrimi civil, banimi, arsimimi, mirëqenia sociale, punësimi, kujdesi shëndetësor dhe trajtimi mjekësor për personat e riatdhesuar në bazë të legjislacionit përkatës. Komuna do të ofroj kurset e gjuhës për fëmijet e riatdhesuar në raste nevojë. Para regjistrimit në kurse të gjuhës, bëhet vlerësimi individual i njohurive të gjuhës që mësohet në shkollë, në mënyrë që të përcaktohet shkalla e njohurive të gjuhës në të cilën mësohet në gjuhën e tij. Fëmijët e riatdhesuar duhet të kenë qasje në shkollë në nivelin e tyre të duhur të arsimimit dhe ndërkohë, duhet të sigurohen dhe të dorëzohen në

⁶⁴ Neni 18 i Rregullores nr.20/2013 për ri-integrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të ri-integrimit



shkollën përkatëse dokumente konkrete të cilat e dëshmojnë nivelin e arsimimit.

Përgjegjësitë e komunave janë përcaktuar si vijon⁶⁵ ;

- Komunitet do të zhvillojnë riintegrimin në nivel lokal si bashkëpunim ndër-sektorial. Secila komunë do të ketë Zyrën Komonale për Kthim dhe Komunitete (ZKKK) dhe Komisionin Komunal për Riintegrim
- Komuna përkatëse është përgjegjëse për zbatimin në nivelin lokal të vendimeve të riintegrit të personave të riatdhesuar dhe për organizimin e dhënies së ndihmës dhe mbështetjes.
- Organi kompetent për çështje të banimit në kuadër të komunës përkatëse duhet të lëshoj vërtetim se personi apo familja e personit në fjalë nuk është përfitues i programi të rindërtimit apo programeve tjera të fushës së banimit.
- Përfitimet dhe ndihma për mbështetjen e riintegrit kryesisht organizohen si pjesë e shërbimeve komunale dhe shërbimeve të tjera lokale në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me autoritetet lokale të mirëqenies sociale, shëndetësisë, punësimit, arsimimit, banimit dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve.
- Komunitet mund të lidhin kontrata për ofrimin e shërbimeve me asociacione ose akterë të tjerë privat.

Në këtë proces një rol i caktuar i është dhënë edhe zyrës Komonale për Komunitetet dhe kthim, në Kuadër të komunave. Përgjegjësitë e kësaj zyre sa i përket procesit të riintegrit dhe ri-atdhesimit janë listuar si vijon:

- Të informojë, ndihmojë dhe

këshillojë personat e riatdhesuar për mundësitë dhe kriteret e përfitimit nga Programi për Riintegrim dhe për plotësimin e kërkesave;

- Të pranojë dhe identifikojë kërkesat e personave të riatdhesuar;
 - Të vlerësojë nevojat preliminare dhe të procedojë kërkesat tek KKR ose tek
- DRPR për vendimmarrje;

- Të mbështesë dhe monitoroj gjendjen e personave të riatdhesuar në koordinim me koordinatorët rajonal;
- Të bashkëpunojë me koordinatorët rajonalë dhe akterët e tjerë lokal;
- Të informojë personat e riatdhesuar për shërbimet që ofrohen nga Zyra për Punësim dhe zyrat e tjera komunale dhe të drejtojë personat në zyra për mbështetje dhe ndihmë të mëtejshme;
- Të mbledhë dhe regjistrojë informatat në bazën e të dhënave;
- Të raportojë në baza të rregullta tek kryetari i komunës dhe tek Këshilli Komunal për rrethanat e komunës në çështjet e riintegrit.

Përveç ZKK në kuadër të komunës themelohet edhe Komisioni Komunal që është organ vendimmarrës në komunë. Komisioni Komunal për Riintegrim merr vendime për kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitime emergjente si vijon

- Paket e ndihmës me ushqim dhe mjete higjienike;
- Pakoja e ndihmës për dimër;
- Pakoja e ndihmës për orendi dhe mjete tjera të asistencës materiale;
- Sigurimi i banimit përmes qirasë së

tregut me bonus banimi; dhe

- Ndihmën e rastit nëse nevojitet për personat e riatdhesuar.

Obligimet e Komunave dhe MAPL-së për ZBATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

Plani i Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave përfshin kriteret gjithëpërfshirëse dhe aktivitetet që ndërlidhen me punën e institucioneve vendore. institucionet vendore janë përgjegjëse për zbatimin e kriterëve dhe rekomandimeve, duke bashkëpunuar ndërmjet vete dhe në partneritet të vazhdueshëm me faktorët ndërkombëtarë të cilët veprojnë në Kosovë, në këtë rast duke përfshirë Komisionin Evropian, Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, EULEX-in dhe projektet mbështetëse. i tërë ky proces ka dalë si rezultat i raportit të parë vlerësues të Bashkimit Evropian për zbatimin e këtij Udhërrëfyesi. Gjithashtu, vlen të theksohet se Plani i Veprimit është hartuar nga të gjithë akterët e përfshirë në këtë proces, vendor dhe ndërkombëtarë, të cilët janë angazhuar në fushat që mbulojnë nga procesi i liberalizimit të vizave, me theks të veçantë në fushën e sundimit të ligjit dhe respektimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Plani i Veprimit përbëhet nga pjesa narrative dhe tabela e veprimeve. Veprimet janë të ndara sipas blloqeve, ku përfshihen⁶⁶:

- Blloku 0: Ripranimi dhe riintegrimi – 28 veprime;
- Blloku 1: Siguria e dokumenteve – 10 veprime;
- Blloku 2: Menaxhimi i kufirit dhe i migracionit – 46 veprime;

⁶⁵ Neni 23 i Rregullores nr.20/2013 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrit

⁶⁶ Plani i Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, fq. 5.

- Bloku 3: Siguria dhe rendi publik - 66 veprime; dhe
- Bloku 4: Të drejtat themelore lidhur me lirinë e lëvizjes – 14.

Buxheti për zbatimin e Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave është rreth 19,158,000€. Përveç kësaj, një pjesë e

konsiderueshme e kostos është e mbuluar me kosto administrative, respektivisht ajo e dedikuar për paga e mëditje, hapësirat e pajisjet ekzistuese, e të cilat tashmë janë të llogaritura në buxhetin e secilit institucion, dhe prandaj nuk janë llogaritur ndaras, por janë evidente si “kosto administrative”. Sa i përket kornizës ligjore dhe

politikave, në kuadër të Planit të Veprimit është paraparë hartimi dhe ndryshim – plotësimet, si dhe azhurnimi i një numri të konsiderueshëm të akteve legislative dhe dokumente të politikave. Në këtë drejtim, fokus i është dhënë më shumë akteve nënligjore ekzistuese të cilat do të rishikohen, ku përmes tyre do të reflektohet në ligjet përkatëse⁶⁷.

OBLIGIMET E MAPL-së QË NDËRLIDHEN ME PLANIN E VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E UDHËRRËFYESIT PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE



Procesi i integrimit të Kosovës në BE dhe detyrimet që dalin nga ky proces, kryesisht kanë të bëjnë me demokratizimin, sundimin e ligjit, si dhe përafrimin e adaptimin e legjislacionit me atë të BE-së (Acquis Communautaire). Për së afërmi, Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave kërkon nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal për të arritur progres në çështjet që lidhen me ri-pranimin dhe ri-integrimin, sigurinë e dokumenteve, menaxhimin e kufijve dhe politikat e migracionit, duke përfshirë sigurimin e qëndrueshëm të rendit dhe të sigurisë publike, si dhe lirinë e lëvizjes. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal si organ mbikëqyrës i komunave është e përkushtuar për të përbushur obligimet e saja karshi proceseve integruese në raport me nivelin lokal të qeverisjes. Një theks i veçantë do t'i kushtohet përmirësimit të vetëdijesimit të përgjithshëm publik dhe të kthyerve lidhur me kthimin, riatdhesimin dhe riintegrimin. Në këtë kontekst, MAPL, në bazë të përgjegjësiqe që i takojnë dhe me qëllim të mbështetjes së nivelit lokal, ka identifikuar disa detyra të cilat kërkohet të përbushen në Planin e Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesisit për Liberalizimin e Vizave, në fushat si:

1 Ngritja e kapaciteteve për riintegrimin e personave të riatdhesuar në nivelin lokal dhe qendror - duke përfshirë: numrin e zyrtarëve shtesë të punësuar në Departamentin për Riintegrim, numri i zyrtarëve shtesë të punësuar në komuna dhe numri i trajnimeve të ofruara zyrtarëve përgjegjës për riintegrimin e personave të riatdhesuar në nivelin qendror dhe lokal;

2 Zhvendosja e fokusit nga programi për riintegrim emergjent tek shërbimet e riintegrimit të qëndrueshëm - duke përfshirë: kryerjen e një vlerësimi të nevojave për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, numri i kurseve të gjuhës të ofruara nxënësve dhe studentëve të riatdhesuar, numri i personave të riatdhesuar të përfshirë në trajnime profesionale;

3 Zotimi dhe shpërndarja e fondit të riintegrimit - shuma e mjeteve financiare nga fondi të zotuar dhe të shpenzuara nga secila kategori të shërbimeve emergjente për vitin 2013, shuma e mjeteve financiare nga fondi të zotuar dhe shpenzuara për secilën kategori të shërbimeve të riintegrimit të qëndrueshëm për vitin 2013;

4 Ngritja e numrit të përfituesve nga programi i riintegrimit - duke synuar numrin e

përfituesve për secilën kategori të shërbimeve i përcaktuar (bazuar në vlerësimin e nevojave për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar);

5 Zbatimi i kodit të etikës në Komuna – parashikimi i nevojës për të pasur një kod të mirësjelljes në të gjitha komunat, me qëllim të ngritjes dhe sigurimit të një niveli më të madh të përgjegjësisë dhe etikës brenda shërbimit civil;

6 Të drejtat e njeriut në nivelin lokal – në këtë fushë, komunat raportojnë në baza periodike për zbatimin e të drejtave të njeriut. Përkundër rolit mjaft aktiv të Njësiqe për të Drejtat e Njeriut në komuna, parashikimi i nevojës për të pasur një buxhet të madh dhe një kod buxhetor të veçantë është i domosdoshëm për njësinë.

7 Fuqizimi i Zyrave Komunale për Kthim dhe Komunitete – në këtë drejtim, ngritja e kapaciteteve dhe aftësiqe të zyrtarëve komunal për të qenë më efikas dhe më efektiv në përbushjen e obligimeve të tyre.

8 Funkcionalizimi i KKSBB-ve në Komuna - në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi



DATA HISTORIKE TË KOSOVËS NË PROCESIN E INTEGRIMEVE EVROPIANE (HISTORIKU I MARRËDHËNIEVE KOSOVË – BE)

Qershor 1999

Themelohet Pakti i Stabilitetit për Europën Jug-Lindore në Cologne, Gjermani

Qershor 1999

BE drejton Shtyllën IV të UNMIK-ut: Rindërtimi dhe Zhvillimi Ekonomik

Shkurt 2000

Themelohet Agjencia Europiane për Rindërtim

Korrik 2000

Këshilli Evropian Feira në Qershor të vitit 2000 njeh të ardhmen e vendeve të Ballkanit Perëndimor si candidate për anëtarësim në BE

Shtator 2000

Aprovohen masa tregtare autonome në mes të Kosovës dhe BE-së

Nëntor 2000

Samiti në mes të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në Zagreb, Kroaci. Lançohet Procesi i Stabilizim Asociimit (SAP).

Dhjetor 2000

Këshilli Evropian adopton Rregulloren 2666/2000 mbi Ndhimën e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim – CARDS

Nëntor 2002

Themelohet Mekanizmi Përcjellës i Procesit të Stabilizim Asociimit.

Dhjetor 2002

Takimi i parë ndër-parlamentar jo-formal në mes të Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës

Qershor 2003

Samiti në mes të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në Selanik, Greqi.

Mars 2004

Takimi i dytë ndër-parlamentar jo-formal në mes të Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës.

Qershor 2004

Këshilli Evropian adopton për herë të parë Partneritetin Evropian për Kosovën.

Gusht 2004

Themelohet Zyra për Integrim Evropian, brenda Zyrës së Kryeministrit.

Shtator 2004

Hapet Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.

Janar 2005

Adoptohet për së pari herë Plan i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Evropian.

Shkurt 2005

Organizohen për herë të parë punëtori sektoriale të Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim Asociimit në fushën e Energjisë dhe Ekonomisë

Prill 2005

Komisioni Evropian adopton një Komunikatë për Këshillin Evropian dhe Parlamentin Evropian mbi “Një të Ardhme Evropiane për Kosovën”

Qershor 2005

Takimi i tretë ndër-parlamentar jo-formal në mes të Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës.

Nëntor 2005

Komisioni Evropian publikon për herë të parë Raportin e Progresit për Kosovën si dhe Letrën e Strategjisë së Zgjerimit



Janar 2006

Këshilli European adopton Partneritetin European për herë të dytë për Kosovën

Mars 2006

Forumi në mes të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në Salzburg.

Maj 2006

Zyra e Integritimit European pasohet nga Agjencia për Integritim European

Qershor 2006

Takimi i katërt ndër-parlamentar jo-formal në mes të Parlamentit European dhe Kuvendit të Kosovës.

Korrik 2006

Këshilli BE-së themelon Instrumentin e Ndhmës për Para-Anëtarësim

Gusht 2006

Adoptohet Plani i Dytë i Veprimit për Implementimin e Partneritetit European

Nëntor 2006

Komisioni European publikon për herë të dytë Raportin e Progresit për Kosovën si dhe Strategjinë e Zgjerimit të BE-së dhe Sfidat Kryesore

Shkurt 2007

Forumi Politike në mes të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në Bruksel, Belgjikë

Nëntor 2007

Komisioni European publikon raportin e tretë të progresit për Kosovën si dhe Strategjinë e Zgjerimit për vitin 2008.

Dhjetor 2007

Nënskruhen Traktati i Reformës si dhe Traktati mbi Funkcionimin e BE-së në Lisbonë.

Dhjetor 2007

Këshilli European konfirmon gadishmërinë e BE-së për t'i asistuar zhvillimit ekonomik dhe politik të Kosovës nëpërmjet një perspective të qartë European në linjë perspektivën Europiane për rajonin.

Janar 2008

Kuvendi i Kosovës themelon Komitetin për Integrim European.

Shkurt 2008

Kuvendi i Kosovës miraton rezolutën që shpall Kosovën shtet të pavarur.

Shkurt 2008

Këshilli i BE-së merr parasysh rezolutën e pavarësisë të Kosovës dhe vëren që vendet anëtare të BE-së do të vendosin vetë, në pajtueshmëri me praktikat vendore dhe të drejtën ndërkombëtare, mbi marrëdhëniet e tyre me Kosovën. Gjithashtu, nënvizon bindjen e BE-së që Kosova përbën një rast sui generis.

Shkurt 2008

Këshilli i BE-së adopton Misionin e BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë (EULEX). Gjithashtu, themelon Zyrën e Përfaqëzuesit Special të BE-së/Zyrën Ndërkombëtare Civile.

Shkurt 2008

Këshilli European miraton për herë të tretë Partneritetin European për Kosovën.

Shkurt 2008

Pakti i Stabilitetit për Europën Jug-Lindore pasohet nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal.

Mars 2008

Publikohet Komunikata e Komisionit European “Ballkani Perëndimor: Zgjerimi i Perspektivës Europiane”

Mars 2008

Mbahet një takim jo-formal i Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të BE-së si dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në Brdo, Slloveni



Prill 2008

Kosova miraton Planin për Integrim Evropian 2008-2010.

Maj 2008

Takimi i parë ndër-parlamentar në mes të Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës.

Qershor 2008

Hyn në fuqi Kushtetuta e Kosovës.

Qershor 2008

Këshilli Evropian rikujton “gadishmërinë e BE-së për të ndihmuar në zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës nëpërmjet një perspektive të qartë Evropiane, në linjë me perspektivën Evropiane të rajonit”.

Korrik 2008

Komisioni Evropian drejton Konferencën e Donatorëve për Kosovën.

Korrik 2008

Miratohet për herë të tretë Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Evropian.

Korrik 2008

Qeveria themelon struktura të reja për Integrim Evropian

Tetor 2008

Qendra e Kordinimit të Donatorëve si dhe Agjencioni për Integrim Evropian bashkohen për të formuar Agjencionin për Kordinimin e Zhvillimit dhe Integrimin Evropian

Tetor 2008

Komisioneri Evropian për Zgjerim, Olli REhn, viziton zyrtarisht Republikën e Kosovës

Nëntor 2008

Komisioni Evropian publikon për herë të katërt Raportin e Progresit për Kosovën si dhe Strategjinë e Zgjerimit 2009.

Shkurt 2009

Kuvendi i Republikës së Kosovës Adopton Rezolutën mbi Prioritetet dhe Strategjitë e Kosovës për Integrim në Unionin Evropian

Mars 2009

Mbahet takim jo-formal i Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare të BE-së si me ata të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Kështjellën e Hlubokës, Republikën Çeke.

Mars 2009

Mblidhet në Prishtinë për herë të parë Forumi i Nivelit të Lartë në mes të autoriteteve të Republikës së Kosovës dhe komunitetit të donatorëve, ku diskutohet mbi projektet në ecuri e sipër dhe alokimin e zotimeve të Konferencës së Donatorëve të vitit 2008 për Kosovën.

Prill 2009

Takimi i dytë ndër-parlamentar në mes të Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës.

Korrik 2009

Përfaqësuesi i Lartë i BE-së, Javier Solana, viziton zyrtarisht Republikën e Kosovës.

Korrik 2009

Miratohet për herë të katërt Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Evropian.

Tetor 2009

Komisioni Evropian publikon për herë të pestë Raportin e Progresit.

Tetor 2009

Komisioni Evropian propozon fillimin e procesit të Liberalizimit të Vizave për Kosovën si dhe negociatat mbi Marrëveshjen Tregtare në mes të Kosovës dhe BE-së.

Tetor 2009

Vendoset Dialogu i Procesit të Stabilizim Asociimit.



Nëntor 2009

Qeveria e Kosovës miraton 10 Prioritetet Strategjike për Integrim Evropian.

Shkurt 2010

Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Cështje me Jashtë, Catherine Ashton viziton zyrtarisht Republikën e Kosovës.

Mars 2010

Samiti i BE-së me Ballkanin Perëndimor në Brdo, Slloveni.

Prill 2010

Themelohet Ministria e Integrimit Evropian.

Prill 2010

Komisioni Evropian dërgon pyetësin për të filluar pregaditjet për Marrëveshjen Tregtare në mes të BE-së dhe Kosovës.

Prill 2010

Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë i Forumit të Nivelit të Lartë në mes të autoriteteve të Republikës së Kosovës dhe komunitetit të donatorëve, me fokus në progresin e arritur gjatë periudhës raportuese (2009 – 2010) në lëvizimin e fondeve të zotuar në Konferencën e Donatorëve për Kosovën dhe në themelimin e strukturave institucionale të Kosovës për koordinim me donatorë.

Maj 2010

Qeveria e Kosovës i dorëzon përgjigjet Komisionit Evropian për Pyetësin e Komisionit Evropian.

Maj 2010

Mbahet në Prishtinë Konferenca “Kosova – progresi në rrugën e integrimit në Bashkimin Evropian”, me pjesëmarrje të shoqërisë civile, mediave, pranisë së BE-së në vend dhe institucioneve qeveritare.

Qershor 2010

Takimi i Nivelit të Lartë në mes të BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë

Qershor 2010

Miratohet për herë të Pestë Plani i Veprimit për Partneritet Evropian.

Korrik 2010

Parlamenti Evropian miraton rezolutën që thërret të gjitha vendet anëtare të BE-së të njohin pavarësinë e Kosovës.

Korrik 2010

Delegacioni i Komisionit Evropian kryen misionin identifikues për Marrëveshje Tregtare.

Korrik 2010

Kosova rishikon dhe priorizon tutje Planin e vet të Veprimit për Partneritet Evropian.

Korrik 2010

Mbahet Takimi i parë Plenar për DPSA.

Gusht 2010

Vizita e Ministrit të Punëve të Jashtme të Gjermanisë z. Guido Westerwelle viziton Prishtinën për t’u takuar me Zyrtarët më të lart shtetërorë të Republikës së Kosovës, si dhe me përfaqësuesit ndërkombëtar në Kosovë.

Shtator 2010

Ministria e Integrimit Evropian dhe Zyra Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë lansojnë ciklin e programimit të pjesës nacionale të Instrumentit për Asistencë të Para-anëtarësimit (IPA) 2010.

Tetor 2010

Lansohet në përdorim Platforma për Menaxhimin e Ndhmës së Jashtme (Aid Management Platform AMP) Platforma për Menaxhimin e Ndhmës së Jashtme (– AMP) është sistem online për menaxhimin e ndihmës së jashtme, gjegjësisht, projekteve, programeve si dhe modaliteteve tjera të asistencës së ofruar nga donatorët.



Shkurt 2011

Zëvendës-Drejtori i Përgjithshëm për Zgjerim i Komisionit Evropian, z. Stefano Sannino viziton Prishtinën. Z. Sannino u takua me përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, lider politikë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues ndërkombëtarë të përfshirë në procesin e Kosovës drejt integritimit në BE. Ai inkurajoi udhëheqësit politikë dhe Qeveritarë për të përkrahur agjendën Europiane dhe reformat si një prioritet i lartë afatshkurtër, i mesëm dhe afatgjatë, për të ardhmen e vendit.

Shkurt 2011

Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë i Nën-Komitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

Mars 2011

Kryeministri Thaçi dhe Shefi i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, z. Renzo Daviddi, nënshkruajnë në Prishtinë Programin Vjetor 2010 të Instrumentit për Asistencë të Para-anëtarësimit (IPA), paketa financiare e të cilit kap vlerën prej gjithsej €63,9 milionë.

Mars 2011

Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë për Bujqësi, Zhvillim Rural, Peshkatari, Pylltari dhe Sigurinë e Ushqimit në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim - Asociimit.

Mars 2011

Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim - Asociimit.

Mars 2011

Qeveria e Republikës së Kosovës miraton Rregulloren nr. 01/2011 për Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në Kuadër të Ministrive.

Prill 2011

Mbahet në Bruksel takimi i dytë me radhë i Nën-Komitetit për Tregun e Brendshëm, Konkurrencën, Mbrojtjen e Shëndetit dhe të Konsumatorit në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

Maj 2011

Ministrja Çitaku i dorëzon Z. Khaldoun Sinno, u.d. Shefit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, Kontributin (Inputin) e parë të autoriteteve të Republikës së Kosovës për Raportin e Progresit 2011 për Kosovën, ku përmbledhen arritjet më të rëndësishme në adresimin e sfidave të Raportit të kaluar të Progresit.

Maj 2011

Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë i Nën-Komitetit për Inovacion, Kapital Njerëzor, Politika Sociale dhe Shoqërinë Informativë në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

Maj 2011

Mbahet në Bruksel takimi i dytë me radhë i Nën-Komitetit për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

Qershor 2011

Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë i Nën-Komitetit për Ekonomi, Financa dhe Statistika në kuadër të Dialogut të Procesit të Stabilizim - Asociimit.

Qershor 2011

Qeveria e Republikës së Kosovës miraton Rregulloren nr. 04/2011 për Koordinimin e Donatorëve, e cila përcakton strukturat institucionale vendore në këtë fushë dhe përgjegjësitë e tyre.

Korrik 2011

Mbahet në Prishtinë Takimi i dytë me radhë Plenar i Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit në mes të autoriteteve të Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, ku diskutohen të arriturat që nga publikimi i Raportit të Progresit 2010 për Kosovën dhe caktohen prioritetet e Agjendës Evropiane për periudhën në vijim.

Korrik 2011

Mbahet në Prishtinë takimi i dytë me radhë i Komitetit të Përbashkët për Monitorim të asistencës së BE- së për Kosovën.



Korrik 2011

Nënshkruhet në Shkup projekti i përbashkët Kosovë – Maqedoni për Bashkëpunim Ndërkufitar (BNK) në kuadër të komponentit të dytë të Instrumentit për Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA).

Korrik 2011

Ministria e Integrimit Evropian dhe Zyra Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë lansojnë ciklin e programimit të pjesës nacionale të Instrumentit për Asistencë të Para-anëtarësimit (IPA) 2012.

Shtator 2011

Ministrja Çitaku i dorëzon Z. Khaldoun Sinno, u.d. Shefit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, Kontributin (Inputin) e dytë me radhë të autoriteteve të Republikës së Kosovës për Raportin e Progresit 2011 për Kosovën, ku përmbledhen arritjet më të rëndësishme në adresimin e sfidave të Raportit të kaluar të Progresit.

Shtator 2011

Ministrja Çitaku viziton Londrën për të diskutuar perspektivën Europiane dhe procesi ne cilin po kalon Kosova drejt integrimit Evropian.

Takimet janë realizuar me zyrtarë të lartë shtetëror të Britanisë së Madhe, z. David Lidington, Ministër për Evropë, z. Andrew Mitchell, Drejtor për Lojra Olimpikë dhe Para – Olimpikë, z. Simon Manley, Drejtor për Evropë, z. Steven O'Brian, Sekretar Permanent në Departamentin për Zhvillim Ndërkombëtar, z. Daniel Fearn, z. Ian Cliff dhe z. David Riley, si dhe takime tjera me zyrtarë të lartë shtetërorë në Mbretërinë e Bashkuar.

Ndërsa në Chatham House, të Londrës u mbajt tryeza e rrumbullakët me temën - “Perspektiva Europiane e Kosovës”. Për marrëdhëniet e Kosovës me Bashkimin Europian dhe vendin e Kosovës në Europë foli Ministrja Çitaku.

Shtator 2011

Ministrja Çitaku dhe Ministrja Shqiptare e Integrimit Evropian, znj. Majlinda Bregu, nënshkruajnë në Prizren projektin e përbashkët Kosovë – Shqipëri për Bashkëpunim Ndërkufitar (BNK) në kuadër të komponentit të dytë të Instrumentit për Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA).

28 Qershor 2013

Samiti Evropian mori vendim për nisjen e negociatave për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së



DATAT KYÇE NË HISTORINË E INTEGRIMIT EVROPIAN

1950

9 maj

Ministri francez i Punëve të Jashtme, Robert Shuman, mban një fjalim të rëndësishëm, duke ofruar propozime të bazuara në idetë e Zhan Monesë. Ai propozon që Franca dhe Republika Federale e Gjermanisë të bashkohen rezervat e veta të thëngjillit dhe çelikut në një organizatë, në të cilën mund të bashkëngjiten shtetet tjera evropiane. Pasi që kjo datë mund të llogaritet si ditëlindja e Bashkimit Evropian, tani 9 maji festohet çdo vjet si “Dita e Evropës”.

1951

18 prill

Në Paris gjashtë shtete - Belgjika, Republika Federale e Gjermanisë, Franca, Italia, Luksemburgu dhe Holanda – e nënshkruan Marrëveshjen, me të cilin themelohet Bashkësia Evropiane për Thëngjill dhe Çelik (ECSC). Hyn në fuqi më 23 korrik, 1952, për periudhë prej 50 viteve.

1955

1-2 qershor

Në takim në Mesina, Ministrat e punëve të jashtme të gjashtë shteteve vendosin të zgjerojnë integrimin evropian në gjitha sferat ekonomike.

1957

25 mars

Në Romë gjashtë shtetet nënshkruajnë Marrëveshjet që themelojnë Bashkësinë Ekonomike Evropiane (BEE) dhe Bashkësinë Evropiane për Energji Atomike (Euratom). Ato hynë në fuqi më 1 janar të vitit 1958.

1960

4 janar

Me insistim të Britanisë së Madhe, Konventa e Stokholmit formon Asociacionin Evropian të Tregtisë së Lirë (EFTA), të përbërë nga një numër shtetesh evropiane që nuk janë pjesë e BEE.

1963

20 korrik

Në Jaunde, nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi mes BEE dhe 18 shteteve afrikane.

1965

8 prill

Nënshkruhet Marrëveshja që bashkon trupat ekzekutive të tre bashkësive dhe krijon Këshill dhe Komision unik. Hyn në fuqi më 1 korrik të vitit 1967.

1966

29 janar

“Kompromisi i Luksemburgut”. Pas një krize politike, Franca pranon të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit me kusht që rregulli i unanimitetit të mbetet në fuqi, nëse bëhet fjalë për “interesa vitale nazionale”.

1968

1 korrik

Të dhënat doganore për mallrat industriale hiqen plotësisht, 18 muaj para afatit dhe prezantohet Tarifa e Përbashkët e Jashtme.

1969

1-2- dhjetor

Në Samitin e Hagës, liderët politikë të BEE vendosin të vazhdojnë me integrimin evropian, duke hapur rrugën për zgjerimin e parë.

1970

22 prill

Në Luksemburg nënshkruhet Marrëveshja që u lejon Bashkësive Evropiane të financohen vazhdimisht nga “resurset e veta” dhe t’i jepen kompetenca më të mëdha Parlamentit Evropian.



1972

22 janar

Në Bruksel nënshkruhen marrëveshjet për praninë në Bashkësitë Evropiane me Danimarkën, Irlandën, Norvegjinë dhe Britaninë e Madhe.

1973

1 janar

Danimarka, Irlanda dhe Britania e Madhe u bashkëngjiten Komuniteteve Evropiane, tani ka nëntë shtete anëtare. Pas një referendumi në të cilin shumica e qytetarëve votuan kundër anëtarësisë, Norvegjia mbetet jashtë bashkësisë.

1974

9-10 dhjetor

Në Samitin e Parisit, liderët politikë të nëntë shteteve anëtare vendosin të takohen tre herë në vjet, si Këshilli Evropian. Ato gjithashtu japin leje për zgjedhje direkte për Parlamentin Evropian dhe vendosin të formojnë Fondin Evropian për Zhvillim Rajonal.

1975

28 shkurt

Në Lomé, nënshkruhet konventa (Lomé I) mes BEE dhe 46 shteteve të Afrikës, Karibeve dhe Pacifikut (ACP).

1975

22 korrik

Nënshkruhet marrëveshja që i jep Parlamentit Evropian kompetenca më të mëdha mbi buxhetin dhe me të cilin themelohet Gjykata Evropiane e Auditorëve. Hyn në fuqi më 1 korrik 1977.

1979

7-10 qershor

Zgjedhjet e para direkte për 410 vende në Parlamentin Evropian.

1981

1 janar

Greqia i bashkëngjitet Bashkësisë Evropiane, duke rritur numrin e shteteve anëtare në dhjetë.

1984

14-17 qershor

Zgjedhjet e dyta direkte për Parlamentin Evropian.

1985

7 janar

Zhak Delor emërohet Kryetar i Komisionit (1985-1995)

14 qershor

Nënshkruhet Marrëveshja e Shengenit, me qëllim që të hiqen kontrollet e pasaportave në kufijtë mes vendeve-anëtare të Bashkësisë Evropiane.

1986

7 janar

Spanja dhe Portugalia u bashkëngjiten Bashkësisë Evropiane, me çka numri i vendeve-anëtare u rrit në 12.

17 dhe 28 shkurt

Në Luksemburg dhe në Hagë nënshkruhet Akti Unik Evropian. Hyn në fuqi më 1 korrik të vitit 1987.

1989

15 dhe 18 qershor

Mbahen zgjedhjet e treta direkte për Parlamentin Evropian.

9 nëntor

Rrëzohet Muri i Berlinit.

1990

3 tetor

Ribashkohet Gjermania.

1991

9-10 dhjetor

Këshilli Evropian në Samitin e Mastroihtit aprovon Marrëveshjen për Bashkimin Evropian, me çka vendosen themelet për politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, bashkëpunim më të afërt në sferën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, si dhe diskuton krijimin e unionit ekonomik dhe monetar, përfshirë valutën unike.

1992

7 shkurt

Në Mastroiht nënshkruhet Marrëveshja për Bashkimin Evropian. Hyn në fuqi më 1 nëntor 1993.

1993

1 janar

Formohet Tregu Unik.

1994

9 dhe 12 qershor

Zgjedhjet e katërta direkte për Parlamentin Evropian.



1995

1 janar

Austria, Finlanda dhe Suedia i bashkëngjiten BE-së, që tani ka 15 anëtarë. Pas një referendumi ku shumica e qytetarëve votuan kundër anëtarësisë, Norvegjia përsëri mbetet jashtë.

23 janar

Fillon me punë Komisioni i ri Evropian (1995-1999), në krye me kryetarin Zhak Santer.

27-28 nëntor

Konferenca Euro-Mesdhetare në Barcelonë vendos partneritet mes BE-së dhe shteteve në bregun jugor të Mesdheut.

1997

2 tetor

Nënshkruhet Marrëveshja e Amsterdimit. Hyn në fuqi më 1 maj të vitit 1999.

1998

30 mars

Fillon procesi i pranimit për shtetet e reja kandidatë. Në këtë proces do të përfshihen Qiproja, Malta dhe dhjetë shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore.

1999

1 janar

Fillim i fazës së tretë të EMU: valutat e 11 shteteve të BE-së zëvendësohen nga euroja, që fillon të qarkullojë në tregjet financiare, duke i zëvendësuar valutat e tyre gjatë transaksioneve me të holla jo të gatshme. Nga ky moment, Banka Qendrore Evropiane (ECB) mban përgjegjësinë për politikën monetare.

Greqia i bashkëngjitet 11 shteteve në vitin 2001.

10 dhe 13 qershor

Zgjedhjet e pesta direkte për Parlamentin Evropian.

1994

9 dhe 12 qershor

Zgjedhjet e katërta direkte për Parlamentin Evropian.

15 shtator

Komisioni i ri Evropian fillon me punë (1999-2004), ku për kryetar emërohet Romano Prodi.

15-16 tetor

Këshilli Evropian në Tampere vendos ta bëjë BE-në një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë

2000

23-24 mars

Këshilli Evropian në Lisbonë harton strategjinë për të nxitur punësimin në BE, duke modernizuar ekonominë dhe sforcuar kohezionin social në një Evropë të bazuar në dije.

7-8 dhjetor

Në Nicë Këshilli Evropian arrin marrëveshje për tekstin e Marrëveshjes së re, me të cilën ndërrohet sistemi vendimmarrës i BE-së, me qëllim që Unioni të jetë i gatshëm për zgjerim. Kryetari i Parlamentit Evropian, Këshillit Evropian dhe Komisionit Evropian solemnisht shpallin Kartën e BE-së për të Drejtat Fundamentale.

2001

26 shkurt

Nënshkruhet Marrëveshja e Nicës. Hyn në fuqi më 1 shkurt 2003.

14-15 dhjetor

Këshilli Evropian në Leken miraton një deklaratë për ardhmërinë e Unionit. Kjo hap rrugën për reformën e madhe të BE-së dhe për formimin e një konvente që do të hartojë kushtetutën evropiane.

2002

1 janar

Në 12 vendet e euro hapësirës fillon të përdoren bankënotat dhe monedhat e euros.

13 dhjetor

Këshilli Evropian në Kopenhagë vendos që dhjetë nga shtetet kandidatë (Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia) mund t'i bashkëngjiten BE-së më 1 maj të vitit 2004.

2003

10 korrik

Konventa për të Ardhmen e Evropës përfundon punën e saj mbi kushtetutën evropiane.

4 tetor

Fillim i konferencës ndërqeveritare, që do të përpilojë marrëveshje të re, ku do të përfshihet edhe kushtetuta evropiane.

2004

1 maj

Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia i bashkëngjiten BE-së.

10 dhe 13 qershor

Zgjedhjet e gjashta direkte për Parlamentin Evropian.



“UDHËZUES PËR ROLIN E KOMUNAVE NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN TË KOSOVËS”

29 tetor

Miratohet Kushtetuta evropiane në Romë (lëndë e ratifikimit nga ana e vendeve anëtare).

22 nëntor

Komisioni i ri Evropian fillon me punë në krye me kryetarin Zhoze Manuel Baroso.

2005

29 maj dhe 1 qershor

Votuesit në Francë gjatë referendumit u deklaruan kundër Kushtetutës, tre ditë më vonë deklarohen kundër edhe votuesit në Holandë.

3 tetor

Fillojnë negociatat me Turqinë dhe Kroacinë.

2006

12 qershor

Shqipëria nënshkruan MSA-në

2007

Bullgaria dhe Rumania i bashkëngjiten Bashkimit Evropian. Sllovenia e pranon euron.

2008

Qershor

Votuesit e Irlandës hodhën poshtë Traktatin e Lisbonës.

2009

Qershor

Zgjedhjet e Parlamentit Evropian, zgjedhjet më të mëdha transnacionale në histori, me 736 deputet të zgjedhur për të përfaqësuar 500 milion evropianë

2011

1 janar

Estonia zyrtarisht hynë në zonën euro

2013

28 qershor

Samiti Evropian mori vendim për nisjen e negociatave për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së

2013

1 korrik

Kroacia zyrtarisht bëhet anëtare e BE-së

2014

1 janar

Latvia zyrtarisht hynë në zonën euro

2014

22-25 maj

Zgjedhjet e Parlamentit Evropian

2014

25 qershor

Shqipëria zyrtarisht merr statusin e kandidatit për BE



HISTORIK I SHKURTËR MBI KRIJIMIN E PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT

- 1 Procesi i Stabilizim Asocimit është gurthemeli i politikës së BE-së ndaj rajonit. Ai synon të avancojë stabilitetin përbrenda regjionit e të njëjtën kohë të mundësojë lidhje me të afërta me Bashkimin Evropian;
- 2 Elementi kyç i PSA-së, për vendet që kanë bërë përparim të mjaftueshëm në rrafshin e reformave politike dhe ekonomike si dhe të kapacitetit administrativ, është vendosja e një raporti formal kontraktues me BE-në në formën e Marrëveshjes për Stabilizim Asocimit;
- 3 PSA-ja është themeluar që t'i ndihmojë çdo vendi të përparojë me dinamikë të vetë drejt integritit të mëtutjeshëm evropian;
- 4 Qasja Regjionale e BE-së synon forcimin e implementimit të marrëveshjeve të Dejtonit/Parisit dhe të Erdutit me qëllim që të sjell stabilitet e prosperitetet në rajon;

5 Në maj të vitit 1999, Komisioni Evropian përcaktoi arsyeshmërinë për të përparuar kah një vizion më ambicioz për zhvillimin e rajonit.

6 Kjo arsyeshmëri ishte bazuar në pranimin se: a) Motivuesi kryesor për reforma – përfshirë krijimin e një sundimi të besueshëm ligjor; b) Institucione demokratike e stabile dhe ekonominë e lirë – në këto vende është raporti i BE-së që bazohet nga mundësia e arritshme e anëtarësimit pas plotësimit të kushteve relevante.

7 Kjo mundësi është ofruar shprehimisht në mbledhjen e Këshillit Evropian të mbajtur në Feria në qershor të vitit 2000. Nevojën për vendosjen e marrëdhënieve bilaterale ndërmjet veti që do të mundësonin një stabilitet më të madh ekonomik e politik, në rajonin që duhet të zhvillohet nevojën për një qasje më fleksibile e cila edhe pse e ankoruar për një tërësi të përbashkët të kushteve politike e ekonomike, i mundëson çdo shteti të përparojë me dinamikë të vet.

8 Programet ndihmuese dhe raportet kontraktuese duhet të jenë fleksibile deri në masën e cila lejon adaptimin në një varg situatash prej rindërtimit të pas luftës e stabilizimit e deri tek ndihma teknike në çështjet siç janë afrimi i legjislacionit kah elementet bërthamë të acquis (tërësisë së ligjeve e rregullave) të BE-së.

9 Marrëveshjet Evropiane mbulojnë çështjet lidhur me: 1) Tregtinë; 2) Dialogun politik; 3) Përafrimin ligjor; 4) Fusha të tjera të bashkëpunimit si: industria, ambienti, transporti dhe doganat;

10 Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është themelimi i zonave të tregtisë së lirë në mes BE-së dhe shteteve të asociuara, gjatë një periudhe të caktuar kohore.

11 Marrëveshjet Asociuese mbulojnë kryesisht të njëjtat fusha, përveç dialogut politik dhe si qëllim kanë krijimin e bashkimit doganor.

12 Marrëveshjet për Stabilizim Asocim janë pjesë e Procesit të Stabilizim Asocimit, proces ky që u inaugurua në maj të vitit 1999 si një strategji e re për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

13 Agjenda 2000 ngriti çështjen “Partneriteti për Aderim” (Accession partnerships), nevojës për asistencë direkte shteteve që t’i tejkalojnë problemet specifike gjatë fazës së paraanëtarësimit dhe mbështetje e adoptimit të Aquis.

14 Acquis Communautaire është i tërë legjislacioni dhe rregullat e përbashkëta të BE-së, përfshinë të gjitha marrëveshjet dhe dosjet ligjore.

15 Kushti kryesor për zgjerimin e BE-së është marrja e plotë e Acquis prej vendeve hyrëse.

16 Acquis ka pasur gjithsejtë 31 kapituj deri me pranimin e Bullgarisë dhe Rumanisë në vitin 2007, kurse për bisedimet me Kroacinë, Turqinë dhe Islandën “acquis communautaire” është ndarë më tepër, në 35 kapituj.

17 Programet e ndihmës së BE-së që u krijuan enkas për Ballkanin Perëndimor janë:
a) OBNOVA që për qëllim kishte rindërtimin, ringjalljen ekonomike dhe rikrijimin e administratës publike në vendet e ish-Jugosllavisë. Ky program, pas përfundimit të luftës në Bosnje e Hercegovinë u shndërrua në programin CARDS;

b) CARDS u bë instrumenti kyç i procesit të Stabilizim Asocimit. Përmes këtij programi BE-ja mëton të ndikojë në çështjet kryesore si: rindërtimi, stabilizimi demokratik, pajtimi e kthimi i refugjatëve, si dhe stabilizimi i institucioneve, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut;

c) IPA- Instrumenti i Para-anëtarësimit i cili përmbledh të gjitha programet ndihmës, u krijua në vitin 2007.



Literatura

- 1 Mile, Klementin: *"15 Pyetje për Bashkimin Evropian"*, Ministria e integritimit, Tiranë;
- 2 Komisioni Evropian: *"Ta gjurmojmë Evropën"*, Drejtorati i Përgjithshëm për Komunikim Publikime 1049 Bruksel, BELGIKË;
- 3 Komisioni Evropian: *"Si funksionon Bashkimi Evropian"*, Udhërrëfyesi juaj për institucionet e BE-së, , Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim Publikimet, B-1049 Bruksel;
- 4 Ministria e integritimit Evropian: *"Versioni i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian"*, Tiranë, Republika e Shqipërisë;
- 5 European Parliament: *"Fact Sheets on the European Union (2014 edition)"*, Luxembourg: Publications Office of the European Union 2013;
- 6 Fonten, Paskal: *"Evropa në 12 leksione"*, Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Komunikim, Publikime B-1049 Bruksel;
- 7 The European Union explained *"How the European Union Works"*, European Commission, Directorate-General Communication Publications, 1049 Brussels, Belgium;
- 8 Reka, Blerim&Holl Otmar&Sela, Ylber: *"Institucionet dhe Politikat e Unionit Evropian"*, Botues Forumi për Shoqëri, Shkencë dhe Kulturë "Universitas" Tetovë 2010;
- 9 Reka, Blerim: *"Gjeopolitika dhe Teknika e Zgjerimit të BE-së"*, botues ASPECT, Bruksel;
- 10 Broshura: *"Standardet për Kosovën"*, UNMIK/IPVQ, dhjetor 2003;
- 11 Ministria e integritimit Evropian: *"Plani i Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit 2014"*, mars 2014, Prishtinë;
- 12 Komisioni Evropian, Kuptimi i Bashkimit Evropian: *"Evropa 2020:Strategjia evropiane e zgjerimit"*, Bruksel, dhjetor 2012;



UEB FAQE TË NDRYMHME:

- 1 <http://www.dadalo-europe.org/int/grundkurs5neu/Chronologie.htm>, autor Prof. Dr. Wolfgang Schumann;
- 2 <http://www.europarl.europa.eu/portal/en> dhe <http://ëëë.results-elections2014.eu/en/election-results-2014.html> përshtatur nga autori i udhëzuesit;
- 3 http://www.pharos-online.org/download/eu_simulation_game/alb/Keshilli_i_Bashkimit_Evropian;
- 4 [http://mapl.rks-gov.net/INTEGRIMET-EVROPIANE.aspx.](http://mapl.rks-gov.net/INTEGRIMET-EVROPIANE.aspx)

